



USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 45 (82646)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 20 nëntor 2015

Prezantohet komandanti i KDS, gjeneral brigade Dedë Prenga



“Eksperienca e tij në auditorët dhe në shtabin e KDS-së, ku rikthehet pasi ka përfaqësuar me dinjitet FA të RSH-së në OSBE dhe disa vende aleate, më krijon bindjen se gjeneral brigade Dedë Prenga do të jetë në lartësinë që i kërkon kjo detyrë”

»» faqe 3

Gjeneral brigade Nazmi Cahani merr detyrën e komandantit të FT



“Kam dy vjet që e njoh gjeneral brigade Nazmi Cahanin dhe që në ditët e para të punës me të, kam gjetur një bashkëpunëtor të aftë dhe serioz, të gatshëm për të gjetur zgjidhje të vlefshme për çdo situatë ”

»» faqe 2

KODHELI NË AMBASADËN FRANCEZE:

Kurajo dhe vendosmëri për të përballuar ngjarjen e rëndë



Takimi

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Miglieta, vizitë zyrtare në Tiranë

Në kuadër të njohjes dhe prezantimit në vendet e rajonit, komandanti i misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR-it, gjeneralmajor Miglieta, javën që kaloi ishte për një vizitë zyrtare në Tiranë. Takimin e parë në serinë e takimeve gjatë qëndrimit të tij njëditor në ...

»» faqe 4



»» faqe 4



KDS

Kursi i 7 i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes vizitë mësimore në Shtabin e NATO-s, Bruksel

Në vijim të programit akademik, studentët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM) 2015 bënë një vizitë mësimore një javore në Shtabin e NATO-s në Bruksel. Grupi i drejtur nga komandanti i AFA Kolonel Prof. Asc. Idriz Haxhijaj, drejtori i KLSM-2015...

»» faqe 5



REPORTAZH

Ushtarakë si nëntoger Budani janë aset i çmuar dhe nder i Forcave të Armatosura

»» faqe 6-7

FORCA AJRORE

Piloti i përjetësisë së hapësirës ajrore shqiptare

faqe 8-9

NATO

Terrorizmi nuk do të mposhtë demokracinë

faqe 13

Kolonel HYSNI GJERGJI

Gjeneral brigade Nazmi Cahani merr detyrën e komandantit të FT

Pas një drejtimi tepër profesional për rreth 3 vjet, nga gjeneralmajor Zyber Dushku, nga dita e sotme Forca Tokësore do të ketë komandantin e saj të ri. Bazuar në Dekretin Nr.9296 të Presidentit të Republikës, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, gjeneral brigade Nazmi Cahani do të jetë komandanti i ri i Forcës Tokësore. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, në garnizonin e Zall-Herit, merrnin pjesë: ministri i Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, komandantët e Forcave, drejtorët dhe ushtarakë të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm, ish-drejtuues të Forcës Tokësore ndër vite etj.

Pas ekzekutimit të Himnit Kombëtar, ceremoninë e hapi komandanti në largim i Forcës Tokësore gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili shprehu falenderim dhe mirënjohje për mbështetjen që Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i dhanë gjatë gjithë periudhës së kryerjes së detyrës së komandantit të FT. Duke iu drejtuar efektivit të FT, ndër të tjera gjeneral Dushku tha: "...Për secilin nga ne vjen një ditë, kur duhet të dorëzojmë stafetën e për të vijuar kontributin në forma të tjera, e tillë është për mua sot. Një ditë e veçantë për t'u kujtuar. Krejt natyrisht në respekt dhe në zbatim të dekretit të Presidentit të Republikës dhe të urdhrat të Ministrisë së Mbrojtjes, dorëzoj detyrën e komandantit të FT, të cilës pata nderin t'i shërbej për pak më shumë se tre vjet... Ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcës Tokësore kudo që jeni, në Tiranë, Shkodër, Berat, në Afganistanin e largët, në fushat e stërvitjes në Gjermani apo të sapokthyer nga Sardenja si pjesëmarrës në stërvitjen "Trident Juncture". Keni vlerësimin dhe mirënjohjen time më të thellë për kontributin dhe punën tuaj të vyer në shërbim të atdheut. Përulem me respekt para jush, duke ju uruar nga zemra shëndet të plotë ju dhe familjeve tuaja, mbarësi në rrugëtimin e mëtejshëm drejt suksesit dhe progresit..." Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneralmajor Zyber Dushku, i uroi suksese komandantit të ri të FT, generalbrigade Cahanit, duke shprehur bindjen se më profesionalizmin që e karakterizon këtë të fundit, Forca Tokësore do të eci e sigurt drejt rritjes së mëtejshme profesionale.

Më pas, ceremonia vazhdoi me një ceremonial ushtarak, ku shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo i dorëzoi Flamurin e Forcës Tokësore komandantit të ri, gjeneral brigade Nazmi Cahani. Gjeneral Cahani, duke marrë fjalën e rastit, vlerësoi marrjen e detyrës së komandantit të FT, jo vetëm si nder dhe privilegj që po i bëhej, por edhe si përgjegjësi e lartë. Në fjalën e tij ai iu drejtua efektivave të Forcës Tokësore, duke kërkuar prej tyre të vazhdonin përgatitjen me të njëjtin profesionalizëm që kanë treguar deri tani. "Ushtarë, ju jeni fuqia e vërtetë e kësaj force, ata që bëjnë të mundur realizimin e misionit të saj. Nga ju unë pres disiplinë të lartë dhe përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave, qofshin ato detyra të përditshme, misione paqeruajtëse apo detyra në ndihmë të komunitetit. Nënoficerë, ju jeni shtylla kurizore e kësaj force sepse luani një rol jetësor në një ushtri profesioniste. Ju stërvitni ushtarët dhe kujdeseni për ta në çdo moment. Me eksperiencën, aftësitë dhe dijet tuaja ju i zhvilloni ata profesionalisht. Ju ndërtoni dhe mbani të gjallë shpirtin kolektiv të ekipit, skuadrës apo togës. Vazhdoni t'i stërvitni ushtarët

Ministrja Kodheli: Kam dy vjet që e njoh gjeneral brigade Nazmi Cahanin dhe që në ditët e para të punës me të, kam gjetur një bashkëpunëtor të aftë dhe serioz, të gatshëm për të gjetur zgjidhje të vlefshme për çdo situatë



në kushte sa më reale dhe me intensitet sa më të lartë dhe vlerësojini ata sipas performancës. Oficerë, si liderët e kësaj force, ju duhet t'i udhëhiqni ushtarët dhe nënoficerët me shembullin tuaj personal.

Vetëm duke dhënë shembullin tuaj ata do t'ju ndjekin në çdo situatë nëse ju jeni të aftë, të sigurt dhe me cilësitë e duhura të një lideri ushtarak. Nga ju kërkohet që t'i trajtoni ushtarët dhe nënoficerët me

drejtesi, respekt dhe dinjitet, të vendosni dhe kërkoni standarde sa më të larta në stërvitje, shërbim apo mision"- tha, ndër të tjera, gjeneral brigade Cahani. Ai gjithashtu falenderoi ministrin e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo për besimin e treguar me emërimin e tij në krye të njësisë më elite të FA, siç është Forca Tokësore. Gjeneral Cahani i siguroi ata se do të punojë me përkushtim, disiplinë dhe ndershmëri të lartë në drejtimin e efektivit të Forcës Tokësore.

Ceremonia e ndërrimit të komandantit të FT u përshëndet edhe nga ministri i Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Duke vlerësuar figurën e ish-komandantit të FT gjeneralmajor Zyber Dushku, zonja Kodheli theksoi: "I titulluar oficer 32 vite më parë, gjeneralmajor Zyber Dushku ka marrë gjithë vlerësimet maksimale të eprorëve, si dhe ka gëzuar simpatinë dhe mbështetjen e të gjithë atyre që kanë punuar krah për krah dhe nën komandën e tij. Profesionalizmi i tij maksimal, i shoqëruar me fjalën e tij të shtruar, e ngriti natyrisht gjeneralin në majat e Forcave

tona të Armatosura. Gjeneral Zyberi na ka përfaqësuar denjësisht edhe në angazhimet tona ndërkombëtare, si komandant i Brigadës së Evropës Juglindore. Sot mbyllet një karrierë e gjatë dhe mbresëlënëse e tij. Por siç ndodh natyrisht për çdo ushtarak, gjeneralmajor Dushku do të jetë gjithmonë me sytë dhe zemrën nga ju, për t'ju këshilluar dhe drejtuar në çdo moment. Ai është një nga ju dhe pret që ju të vazhdoni ta bëni krenar!"

Në vazhdim të fjalës së saj përshëndetëse, znj. Kodheli duke iu drejtuar komandantit të ri të FT tha: "Sot hapet një faqe e re në karrierën e gjeneralit të brigadës Nazmi Cahani. Komandanti i ri i Forcës Tokësore, është një nga ata ushtarakë që shtynë përpara në çdo moment, me ide, me kurajë, profesionalizëm dhe përkushtim. Kam dy vjet që e njoh gjeneral Nazmiun dhe që në ditët e para të punës me të, kam gjetur një bashkëpunëtor të aftë dhe serioz, të gatshëm për të gjetur zgjidhje të vlefshme për çdo situatë. Të shumta janë sfidat për ju gjeneral Nazmiu. Forca Tokësore mban peshën më të madhe të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, por dhe mban gjithë angazhimin ndërkombëtar ushtarak të Republikës së Shqipërisë...". Të pranishmit në ceremoni, realizuan një foto të përbashkët, si një kujtim i bukur i kësaj ngjarje të shënuar jo vetëm për FT, por për të gjithë Forcat e Armatosura Shqiptare. Gjeneral brigade Nazmi Cahani vjen në detyrën e komandantit të Forcës Tokësore, pas një karriere të gjatë dhe të suksesshme në FA, ku detyra e tij më e fundit ishte ajo e drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Ai bëhet në këtë mënyrë, që nga koha e krijimit të kësaj strukture, pas ndryshimeve demokratike në vend. Kujtojmë se para tij këtë detyrë e kanë mbajtur gjeneralmajor Kostaq Karoli, gjeneral brigade Shpëtim Spahiu, gjeneralmajor Viktor Berdo dhe gjeneralmajor Zyber Dushku.

Fjala e ministres Kodheli në ceremoninë e prezantimit të komandantit të ri të FT

Përshëndetje të gjithëve, të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, fort i nderuar gjeneral Bazo, të nderuar të ftuar.

Gjatë muajve shtator dhe tetor kam pasur rastin të marr pjesë në disa angazhime tuaja të mëdha. Stërvitje si ajo e Bizës apo e Rreth-Grethit kanë qenë momente të rëndësishme në kalendarin stërvitor të Forcës Tokësore. Dhe pa dyshim që vjeshta e këtij viti, me pjesëmarrjen në stërvitjen "Trident Juncture" të NATO-s, konfirmoi edhe një herë se detyrimet që kemi në kuadër të Aleancës, i kemi marrë seriozisht dhe po i përmbushim ato çdo ditë. Ndaj unë ju përgëzoj për këtë. Por dita e sotme mbart një të veçantë të madhe. Po mbyllet një cikël i rëndësishëm në drejtimin e Forcës Tokësore. Gjeneralmajor Zyber Dushku, pas tre vitesh drejtimi, ka përmbushur detyrimin që i njeh ligji dhe i shtohet radhëve të mijëra oficerëve të suksesshëm të cilët, të palodhur nga vështirësitë e profesionit, kanë drejtuar njësitë e Forcave tona të Armatosura në këtë proces të gjatë transformimi që bëri të mundur anëtarësimin e vendit tonë në NATO si dhe pjesëmarrjen në operacionet më të rëndësishme që komuniteti ndërkombëtar ka marrë pjesë. I titulluar oficer 32 vite më parë, gjeneralmajor Zyberi ka marrë gjithë vlerësimet maksimale të eprorëve si dhe ka gëzuar simpatinë dhe mbështetjen e të gjithë atyre që kanë punuar krah për krah dhe nën komandën e tij. Profesionalizmi i tij maksimal, i shoqëruar me fjalën e tij të shtruar, e ngriti natyrisht gjeneralin në majat e Forcave tona të Armatosura. Gjeneral Zyberi na ka përfaqësuar denjësisht edhe në angazhimet tona ndërkombëtare, si komandant i Brigadës së Evropës Juglindore. Sot mbyllet një karrierë e gjatë dhe mbresëlënëse e tij. Por siç ndodh natyrisht për çdo ushtarak, gjeneralmajor Zyber Dushku do të jetë gjithmonë me sytë dhe zemrën nga ju, për t'ju këshilluar dhe drejtuar



në çdo moment. Ai është një nga ju dhe pret që ju të vazhdoni ta bëni krenar!

Sot hapet një faqe e re në karrierën e gjeneral brigade Nazmi Cahani. Komandanti i ri i Forcës Tokësore është një nga ata ushtarakë që shtynë përpara në çdo moment, me ide, me kurajë, profesionalizëm dhe përkushtim. Kam dy vjet që e njoh gjeneral Nazmiun dhe që në ditët e para të punës me të, kam gjetur një bashkëpunëtor të aftë dhe serioz, të gatshëm për të gjetur zgjidhje të vlefshme për çdo situatë. Të shumta janë sfidat për ju gjeneral Nazmiu. Forca Tokësore mban peshën më të madhe të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, por dhe mban gjithë angazhimin ndërkombëtar ushtarak të Republikës së Shqipërisë. Vepërimet destabilizuese ushtarake në kufijtë lindorë të NATO-s dhe pasiguria në rritje në Mesdheun Jugor kanë sjellë nevojën e një reagimi të përbashkët nga të gjitha vendet e Aleancës sonë. Ngjarjet që po ndodhin në Ukrainë, Siri, Irak dhe jo vetëm, demonstrojnë rëndësinë që ka mirëpërgatitja për parandalimin e çdo agresioni të mundshëm ndaj Aleancës apo për t'iu përgjigjur çdo krize të mundshme. Rajoni në të cilin jetojmë është krejtësisht i përfshirë në vorbullat që po krijohen si në Lindje ashtu edhe në Jug. Valët e refugjatëve që po vijnë drejt Europës forcojnë nevojën për të gjetur një zgjidhje që prek rrenjëjt e problemit dhe jo vetëm pasojat e tij. Dhe ne të gjithë i kemi sytë tek Forca Tokësore. Jemi të gatshëm për t'iu përgjigjur rreziqeve me eksperiencën e fituar ndër vite, krah për krah me aleatët tanë të NATO-s. Procesi i modernizimit tuaj sapo ka filluar. Do të vazhdojmë me projekte konkrete edhe në vitet e ardhshme. Ndaj unë nga zemra i uroj punë të mbarë gjeneral Cahanit dhe suksese të mëtejshme Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju faleminderit!

STAFI

Kryeredaktor:
Muharrem DARDHA

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Albert ZHOLI

Gazetarë:
Saimir ALIJA
Etleva SMAÇI

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ
Redaktore/Korrektore:
Anila DODA

ADRESA:
Ministria e Mbrojtjes,
Bulevardi "Zhan D'Ark"

Prezantohet komandanti i KDS, gjeneral brigade Dedë Prenga

Ministrja Kodheli: Eksperienca e tij në auditorët dhe në shtabin e KDS-së, ku rikthehet pasi ka përfaqësuar me dinjitet FA të RSH-së në OSBE dhe disa vende aleate, më krijon bindjen se gjeneral brigade Dedë Prenga do të jetë në lartësinë që i kërkon kjo detyrë

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ka prezantuar komandantin e ri të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Dedë Prenga. Duke përshëndetur në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ministrja Kodheli theksoi se, qysh në fillim, dua t'i uroj suksese dhe punë të mbarë gjeneral brigade Dedë Prengës. Pas përpjekjeve për të transformuar arsimimin e ushtarakut të FA-së dhe për rishikimit të të gjitha kurrikulave, gjeneral brigade Dedë Prenga merr sot barrën dhe mundësinë për të ndikuar pozitivisht në formimin e ushtarakëve, për t'i aftësuar dhe përgatitur ata me dinjitetin e një profesioni të nderuar. Me këtë rast, ministrja Kodheli ka përgëzuar dhe zëvendëskomandantin e KDS, kolonel Ruzhdi Kuçin për përpjekjet edhe barrën e mbajtur në një periudhë pothuaj dy vjeçare në krye të KDS. Në vazhdim të fjalës së saj, ministrja Kodheli ka nënvizuar se, sfidat e reja kërkojnë përjasje të reja dhe arsimimi, trajnimi e stërvitja nevojitet të nisë një fazë tjetër kritike, e cila të zhvillojë potencialin e liderhipit të FA-së bazuar në situatën e sotme të sigurisë. "Do të dëshiroja të shihja përkushtimin dhe angazhimin tuaj të përbashkët për të forcuar themelet e profesionalizmit ushtarak. Sfidat e shumfishta dhe kërcënimet hibride shtrojnë sot nevojën për studime aplikative që do të trajtojnë problemet dhe sfidat e FA-së dhe ti shërbejnë si të ardhmes së tyre ashtu edhe forcimit të themeleve të profesionit të ushtarakut", - është shprehur znj. Kodheli.

Në fund të fjalës së saj, ministrja Kodheli ka garantuar

mbështetjen maksimale për gjeneral brigade Ddedë Prenga në përmbushjen me sukses të detyrës dhe misionit të tij si komandant i Komandës së Ddoktrinës dhe Stërvitjes.

Gjeneral brigade Prenga shprehu mirënjohjen ndaj ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për besimin e dhënë, në emërimin e tij me detyrën e rëndësishme si komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Ai siguroi angazhimin e tij personal dhe të gjithë stafit të KDS-së për dhënien e një impuls të ri punës nëpërmjet profesionalizmit, përkushtimit dhe në bashkëpunim me të gjithë aktorët brenda dhe jashtë dikasterit në interes të misionit të saj si pjesë vitale e misionit kushtetues që kanë FA të Republikës së Shqipërisë.

Gjeneral brigade Dedë Prenga vjen në detyrën e komandantit të KDS-së, pas një karriere të gjatë dhe të suksesshme në FA dhe në strukturat e sistemit tonë arsimor ushtarak. Detyra e tij më e fundit ishte ajo e Përfaqësuesit të Lartë Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Austri. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast në sallën e mbledhjeve të Ministrisë së Mbrojtjes morën pjesë edhe zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, drejtorë dhe ushtarakë të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, ushtarakë dhe punonjës civil të KD-së, Akademisë së FA etj.



Fjala e ministres së Mbrojtjes Kodheli

I nderuar Gjeneral Bazo,
të nderuar zotërinj gjeneralë,
të nderuar zonja dhe zotërinj, ushtarakë, atashë ushtarakë,
të nderuar të pranishëm.

Pas fundjavës së zyrtë dhe të dhimbshme, ende të shokuar nga masakra barabare dhe e shëmtuar e ndodhur në Paris, mbledhemi sot në ceremoninë e marrjes së detyrës së rëndësishme të Komandantit të Doktrinës dhe Stërvitjes, prej Gjeneral Brigade Dedë Prenga. Kjo ceremoni pason atë të disa ditëve më parë, kur Komandanti i Forcës Tokësore, mori detyrën ditën e premte. Qysh në fillim, dua t'i uroj suksese dhe punë të mbarë Gjeneral Dedë Prengës. Suksese gjeneral në këtë detyrë që hap fazën e re të karrierës tuaj, në këtë moment, kur arsimimi, stërvitja dhe trajnimi merr rëndësi, jo vetëm për të zhvilluar kapacitetet e FA-së, por edhe për të përmirësuar realitetin dhe për të shtyrë FA në rrjedhën e një të arhmeje të sigurtë, ashtu si dhe vendin, drejt një të ardhmeje më të sigurt. Pas përpjekjeve për të transformuar arsimimin e ushtarakut të FA-së dhe pas rishikimit të të gjitha kurrikulave, gjeneral brigade Dedë Prenga merr sot barrën dhe mundësinë për të ndikuar pozitivisht në formimin e ushtarakëve, për t'i aftësuar dhe përgatitur ata me dinjitetin e një profesioni të nderuar.

Eksperienca e tij në auditorët dhe në shtabin e KDS-së, ku rikthehet pasi ka përfaqësuar me dinjitet FA të RSH-së në OSBE dhe disa vende Aleate, më krijon bindjen se gjeneral brigade Dedë Prenga do të jetë në lartësinë që i kërkon kjo detyrë. Kjo bindje përforcohet prej ekspertizës së vyer në shërbimin me trupa, e gërshetuar me integritetin, përgjegjshmërinë dhe përkushtimin e tij të padiskutueshëm. Me këtë rast



duke e përgëzuar dhe zëvendëskomandantin, Kolonel Kuçin për përpjekjet edhe barrën e mbajtur në një periudhë pothuaj dy vjeçare, dua t'i drejtohem edhe stafit të KDS-së, krahas besimit tim, se drejtimi i gjeneral Prengës do të japë një dimension të ri punës në këtë institucion, pres një qëndrim të ri prej gjithë stafit për të avancuar mendimin dhe arsimin ushtarak.

Sikurse dihet arsimimi është investim afatgjatë, efektet e të cilit ndihen në dekadën e ardhshme. Duke menduar prioritetet e arsimimit, mendoj për sfidat ende të pakapërcyera, që lidhen me cilësinë, programet gjithëpërfshirëse dhe metodologjinë bashkëkohore që duhet implementuar në arsimimin ushtarak nga stafi i KDS-së. Transformimi i FA kërkon perceptim të ri të punës në arsim, apo në zhvillimin e doktrinave. Megjithatë KDS nuk ka kapacitete ushtarake që ti angazhojë në vijën e parë të frontit roli i KDS është esencial dhe prezent me nivelin e përgatitjes së liderhipit dhe ndërveprueshmërinë e kapaciteteve. Në këto kohë rreziqesh dhe kërcënimesh të paparashikuara, ekspertët e strategjisë dhe gjeopolitikës në KDS duhet të analizojnë dhe vlerësojnë në vijimësi



zhvillimet dhe situatën, si dhe të ri-përcaktojnë principet dhe rolin e FA-së në të ardhmen.

Sfidat e reja kërkojnë përjasje të reja dhe arsimimi, trajnimi e stërvitja nevojitet të nisë një fazë tjetër kritike, e cila të zhvillojë potencialin e liderhipit të FA-së bazuar në situatën e sotme të sigurisë. Institucionet e KDS-së të reflektojnë mbi rolin e tyre në përmirësimin e programeve, modernizimin e metodologjisë dhe aplikimin e mësimet në nxjerra për përgatitjen e drejtuesve me kreativitet dhe iniciativë nëpërmjet arsimimit bashkëkohor. Do të dëshiroja të shihja përkushtimin dhe angazhimin tuaj të

përbashkët për të forcuar themelet e profesionalizmit ushtarak. Sfidat e shumfishta dhe kërcënimet hibride shtrojnë sot nevojën për studime aplikative që do të trajtojnë problemet dhe sfidat e FA-së dhe ti shërbejnë si të ardhmes së tyre ashtu edhe forcimit të themeleve të profesionit të ushtarakut.

Krahas formimit taktik dhe teknik të drejtuesve, nevojitet modernizimi i doktrinës për t'i pabaraprirë zhvillimit të kapaciteteve. Përveç se, nevojitet edukim, stërvitje dhe trajnim bazuar në skenarët realë, jemi të vonuar në ofrimin e kurseve të trajnimit online dhe në krijimin e një biblioteke

dixhitale me të gjitha manualët dhe publikimet e MM-së. Ndërkohë, pres të angazhoheni gjithë aftësitë dhe kapacitetet, pasi ka kaluar koha që KDS ishte institucioni i vegjetimit në rehati apo mbijetesës për disa që nuk vlenin askund tjetër, as vendi i rehatisë për ditët e pushimit dhe as trampolina në gradën e radhës. Posti juaj është po aq sfidues sa dhe detyra e komandantit në trupave, por me një dimension më intelektual. Këtë e pres dhe e pretendoj prej jush. Prej meje gjeneral Deda keni mbështetjen maksimale për t'ia mbërritur këtij qëllimi. Ndaj edhe njëherë ju uroj suksese dhe punë të mbarë në këtë sfidë të re.

Ministria e Mbrojtjes Kodheli, ngushëllime për popullin francez

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ishte sot në Ambasadën Franceze në Tiranë. Ajo u prit nga ambasadori i Republikës së Francës, z. Bernard Fitoussi, të cilit ministria Kodheli i shprehu keqardhjen e thellë për sulmin terrorist që ka ndodhur para pak ditësh në Paris. Më pas, e shoqëruar nga ambasadori Fitoussi, ministria Kodheli ka lënë shënimet e saj në Librin e Ngushullimeve, ku edhe njëherë shprehu ngushullimet e saj për popullin francez dhe për Republikën Franceze për viktimat nga sulmet terroriste që u shkaktuan pak ditë më parë në kryeqytetin francez, duke nënvizuar kurajon dhe vendosmërinë për të përballuar këtë ngjarje të rëndë dhe qëndresën e popullit francez për të ruajtur paqen dhe lirinë.



Batalioni i Vaut të Dejës kontribut për shuarjen e zjarrit në Vermosh

Në ndihmë të komunitetit

Javën që kaloi në territorin e njësisë administrative Vermosh, Kelmend, ra një zjarr masiv. Në ndihmën e kësaj situatë të rënduar kanë shkuar menjëherë efektivat Batalionit të Parë të Këmbësorisë (b1k) në Vaun e Dejës, në vartësi të Forcës Tokësore. Kanë qenë rreth 40 forca dhe 2 mjete të këtij batalioni që janë nisur menjëherë në vendngjarje për shuarjen e flakëve të zjarrit, të cilat ishin përhapur në një terren prej 1.2 hektarësh, kryesisht pyje. Major Latif Bajraktari, i cili drejtoi trupat e b1k gjatë këtij operacioni, sapo ka arritur në zonën e operacionit, ka kontaktuar me drejtuesit e pushtetit lokal dhe pasi ka marrë informacionin për zonën e përhapjes së zjarrit, ka



bërë menjëherë ndarjen e forcave dhe mjeteve për vënien në kontroll të zjarrit. Pasi janë përqëndruar kryesisht në zonën veriperëndimore të vatrës së zjarrit, efektivat e b1k të Forcës Tokësore në bashkëpunim edhe me forcat e policisë dhe të zjarrfikësve të zonës, kanë arritur që pas rreth 1 orë e 30 minuta të shuajnë komplet zjarrin që kishte rënë në zonën e Vermoshit në Kelmend. Me këtë rast, efektivat ushtarakë të b1k të FT kanë marrë falenderimet dhe mirënjohjen jo vetëm të drejtuesve të pushtetit lokal të zonës, por edhe të banorëve të kësaj zone, të cilët kanë ndjerë gjithmonë prezencën dhe ndihmën e Forcave të Armatosura në raste të fatkeqësive natyrore.



Komandanti i KFOR-it vizitë zyrtare në Tiranë

Në kuadër të njohjes dhe prezantimit në vendet e rajonit, komandanti i misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR-it, gjeneralmajor Miglietta, javën që kaloi ishte për një vizitë zyrtare në Tiranë. Takimin e parë në serinë e takimeve gjatë qëndrimit të tij njëditor në Tiranë e pati me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. "Personalisht dhe në emër të Forcave të Armatosura ju falënderoj për lidhshmërinë dhe treguar si komandant i KFOR-it dhe për gjithçka ju, stafi juaj dhe trupat që keni nën komandë kanë bërë e bëjnë për të ruajtur historinë e suksesit të angazhimit të NATO-s në Kosovë", - tha gjeneralmajor Bazo në fillim të fjalës së tij të mirëseardhjes. Ai falënderoi gjithashtu gjeneralmajor Miglietta edhe për asistencën dhe mbështetjen që KFOR-i ka ofruar Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe përpjekjet për finalizimin e procesit të krijimit të një ekipi të vetëm këshillimi të NATO-s, nga dy që janë tani. "Shqipëria, - theksoi gjeneralmajor Bazo dhe Forcat e saj të Armatosura, - ashtu si deri më tani do të vijojnë të mbështesin KFOR-in në përmbushjen e angazhimeve të tij". Në vijim gjeneralmajor Bazo solli në vëmendjen e bashkëbiseduesit se edhe në takimin e fundit të Komitetit Ushtarak në Stamboll, Turqi dhe më vonë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të Aleancës, KFOR ishte në axhendën e tyre dhe të dy forumet vazhdojnë ta konsiderojnë një histori suksesi të Aleancës, por që duhet të vijojë dhe të përshtatet në sasi varësisht nga kushtet në terren.

Nga ana e tij, komandanti i KFOR, gjeneralmajor Miglietta, pasi falenderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo, për mikpritjen dhe për fjalët e mira thënë në adresë të KFOR, njohu bashkëbiseduesin me situatën më të fundit në Kosovë parë nën perspektivën e KFOR-it, me angazhimin e vazhdueshëm të KFOR për një mjedis të sigurt dhe liri lëvizjeje, si dhe marrjen e masave për të qenë të aftë t'i përgjigjen sfidave të ardhshme. Gjithashtu, ai vlerësoi kontributin e Shqipërisë në misionin KFOR dhe performancën e lartë të treguar nga ushtarakët shqiptarë. Më tej të dy bashkëbiseduesit ndanë opinionet dhe mendimet e tyre lidhur me disa prej sfidave aktuale që mund të kërkojnë angazhimin, respektivisht të KFOR dhe të Forcave të Armatosura. Ndër to ishin përballimi i një fluksi të mundshëm refugjatësh lufte nga kufijtë jugorë të Aleancës, si dhe fenomenin e "luftëtarëve të huaj".



Admirali Mark Ferguson zhvilloi një vizitë në Komandën e Forcës Detare

Komandanti i Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO (JFC) në Napoli, admiral Mark Ferguson, javën që kaloi ishte për një vizitë dy ditore në vendin tonë. Qëllimi i kësaj vizite është takimi me autoritetet më të larta politiko - ushtarake në Shqipëri dhe diskutimi i çështjeve të sigurisë në rajonin e Ballkanit dhe Krahu jugor të NATO, si dhe bashkëpunimi midis Forcave të Armatosura të RSH dhe JFC. Në këtë kuadër, admiral Ferguson zhvilloi një vizitë edhe në Komandën e Forcës Detare ku u prit me një truproje nderi marinarësh të kësaj force. Në vijim të vizitës, Admirali Ferguson zhvilloi një takim me komandantin e Forcës Detare, gjeneral brigadë Ylber Dogjani dhe kuadër të shtabit të kësaj force. Fillimisht gjeneral brigadë Dogjani i uroi mirëseardhjen admiral Ferguson dhe ushtarakëve të lartë të ekipit të tij. Më pas e falënderoi ushtarakun e lartë amerikan të NATO-s për ndihmën e dhënë Forcës sonë Detare nga Departamenti i Shtetit dhe Flota e SHBA. Kjo ndihmë në asistencë teknike, trajnim, arsimim, stërvitje të përbashkëta etj., ka rritur kapacitetet operacionale të Forcës Detare, theksoi gjeneral Dogjani. Gjatë takimit u bë një prezantim i shkurtër për historikun e FD, misionin, detyrat, struktura, organizimi, fushat e bashkëpunimit me Flotën e 6-të të SHBA dhe me Komandën JFC Napoli, bashkëpunimi me institucionet e tjera detare, modernizimi e reformimi në të ardhmen, etj. Gjithashtu gjatë takimit ushtarakët e ty dy palëve diskutuan për mundësinë e shkëmbimit të informacionit midis Forcës Detare dhe Komandës së Bashkuar Napoli.

Në fund të takimit admiral Ferguson e falënderoi komandant Dogjanin për pritjen e rezervuar dhe i uroi atij suksese në detyrën e komandantit të Forcës Detare. Ndërkohë në librin e vizitorëve Admirali la shënime dhe vlerësoi punën e personelit të Forcës Detare Shqiptare dhe i uroi suksese në zbatimin e misionit fisnik për ruajtjen dhe zbatimin e ligjëshmërisë detare.

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes

Kursi i 7 i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes vizitë mësimore në Shtabin e NATO-s, Bruksel

Në vijim të programit akademik, studentët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM) 2015 bënë një vizitë mësimore një javore në Shtabin e NATO-s në Bruksel. Grupi i drejtur nga komandanti i AFA Kolonel Prof. Asc. Idriz Haxhijaj, drejtori i KLSM-2015, kolonel Dr. Çlirim Toci, realizoi vizita të rëndësishme në Shtabin e NATO-s në Bruksel, në misionin Shqiptar atje, në SHAPE, si dhe në Ministrinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Belgjikës.

Në Shtabin e NATO-s në Bruksel grupit i uroi mirëseardhjen zj. Despina Afentouli, Oficere Programimi në Drejtorinë e Diplomacisë Publike. Pjesë e programit ishin edhe brifingjet të mbajtura nga personalitete në lidhje me problemet e sigurisë dhe sfidat e saj,



prioritetet politike të NATO-s, politikat e mbrojtjes etj.

Më pas grupi u prit nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në NATO, z. Mr. Leonard Demi dhe

nga Përfaqësuesi Ushtarak i Shqipërisë në NATO, gjeneralmajor Qemal Shkurti.

Në SHAPE grupi u prit nga përfaqësuesi ushtarak i Shqipërisë,

kolonel Arjan Hilaj. Gjatë vizitës u brifua rreth veprimtarisë së Shtabit, (ACO) dhe menaxhimit të operacioneve dhe krizave. Më pas, gjeneral lejtënant Michel Takovleff, zv/shëf i

Shtabit të Komandës Operacionale të Aleancës, (ACO), zhvilloj një bashkëbisedim me studentët dhe stafin akademik të KLSM - 2015.

Gjatë vizitës në Ministrinë e Mbrojtjes të Mbretërisë së Belgjikës grupi u prit nga gjeneral lejtënant Buschenschmid, ndihmësi i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për Strategjinë. Më pas, kolonel Bart Laurent mbajti brifing mbi pjesëmarrjen e FA të Belgjikës në operacione. N/ Kolonel Geert Schouëaert mbajti brifing mbi Politikën e Mbrojtjes së Mbretërisë së Belgjikës, ndërsa gjeneral lejtënant Buschenschmid dhe ekipi i tij iu përgjigjen pyetjeve të studenteve dhe stafit akademik.

Në vijim të procesit mësimor studentët e KLSM, krahas programit të përzgjedhur akademik, do të vijojnë vizitat mësimore edhe në vende të tjera.

“Lektor nderi” në KLSM: Ambasadori i Turqisë, Hidayet Bayraktar

Dy ditë më parë, ambasadori i Turqisë në vendin tonë, z. Hidayet Bayraktar, në cilësinë e “Lektorit të nderit”, zhvilloi me studentët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes-2015 leksionin me temë: “Perspektiva Turke/ Këndvështrimi në zhvillimet aktuale gjeopolitike në rajonin e Ballkanit dhe në Lindjen e Mesme”. Zoti Hidayet Bayraktar shoqërohej nga atasheu ushtarak i Turqisë, kolonel Bayram Talci njëkohësisht edhe student në KLSM- 2015. Ambasadori Turqisë vuri në dukje se sigurimi i paqes dhe sigurisë në Ballkan e kudo në botë është qëllimi kryesor i diplomacisë. Gjatë lektimit zoti Hidayet Bayraktar foli mbi situatën e sotme në Ballkan, luftën kundër terrorizmit, IS-is, krizat e konfliktet, krizën e refugjatëve dhe emigracionin. Në aspektin se si Turqia e shikon rajonin e Ballkanit, Ambasadori Hidayet Bayraktar nënvizoi se rajoni i Ballkanit është i destinuar për t’iu bashkuar Bashkimit Evropian nëpërmjet krijimit të urave të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për të bërë më të mirën për vendet e Ballkanit. Ambasadori Turk Bayraktar iu përgjigj



edhe shumë pyetje që u bënë nga studentët e KLSM-2015 në lidhje me çështjet e sigurisë në rajonin tonë dhe më gjerë. Në emër të pjesëmarrësve të KLSM-2015, kolonel Arseni Tsukhishvili, student në KLSM-2015, i dorëzoi Ambasadorit të Turqisë, z. Hidayet Bayraktar “Certifikatën e Mirënjohjes”. Në fund të këtij takimi, ambasadori i Turqisë, z. Hidayet Bayraktar, bëri një foto të përbashkët me studentët e Kursit të 7 të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes 2015.



“Lektor nderi” në KLSM: Ambasadori i Greqisë, Leonidas Rokanas

Ambasadori i Greqisë në Tiranë, z. Leonidas Rokanas në cilësinë e “Lektorit të nderit” zhvilloi me studentët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes -2015 leksionin me temë “Perspektiva Greke/ Këndvështrimi në zhvillimet aktuale gjeopolitike në rajonin e Ballkanit dhe në Lindjen e Mesme”. Ambasadori Rokanas gjatë lektimit u ndal në trajtimin e situatës së sotme në rajonin e Ballkanit e më gjerë, krizat dhe konfliktet, krizën e refugjatëve dhe emigracionin, luftën kundër terrorizmit, IS-is, si dhe perspektivën e vendeve të Ballkanit. Në fund të ligjëratës së tij, ambasadorit grek i u bënë mjaft pyetje nga studentët e KLSM-2015 në lidhje me çështjet e rajonit, por edhe më gjerë. Në emër të pjesëmarrësve të KLSM-2015, kolonel Arseni Tsukhishvili, student në KLSM-2015, i dorëzoi ambasadorit të Greqisë, z. Leonidas Rokanas, “Certifikatën e Mirënjohjes”. Ambasadori i Greqisë, Leonidas Rokanas bëri në fund një foto të përbashkët me studentët e Kursit të 7 të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes 2015.

Merita Alimuçaj

Vlerësim maksimal për kursin EOD në Komandën Mbështetëse

Përfaqësues nga Garda e New Jersey dhe EU-COM, Gjermani, me pjesëmarrës kapter Niedwiadek, kapter Rolfe dhe rreshter Hurley zhvilluan një takim pune njëjavor në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse. Morën pjesë instruktorët e kursit EOD nivel i parë, zëvendëskomandanti i kompanisë EOD kapiten Azizi, si dhe shefi i seksionit të xhenios në QSKM kapiten Nuredini dhe përfaqësues nga FSK kompania EOD tetar Reshitaj. Kursi EOD u vlerësua me nota maksimale nga palët, si një kurs i domosdoshëm dhe që rrit nivelin e njohurive për instruktorët e rinj EOD. Kursi arriti pritshmëritë e duhura.

Në takim u analizua ecuria e kursit, mësimet e nxjerra, çfarë shkoi mirë dhe çfarë duhet përmirësuar në kurset e ardhshme, si dhe lista e materialeve që do dhurohen për mbarëvajtjen e kurseve në vazhdim.



Gjatë këtij takimi, u parashikuan 2 aktivitete për vitin 2016 po të këtij niveli. Për kursin në vijim u ra dakord që kohëzgjatja do të jete 12 javë, si dhe do futen risi të reja mbi nxjerrjen dhe asgjësimin e municioneve të Luftës së Dytë Botërore që janë në thellësi ujore, si dhe trajnimin i avancuar në shpëtim jete. Ndihma nga pala amerikane dhe EUCOM, Gjermani, për vazhdimin e kursit të instruktorit EOD do të jetë e pa kursyer duke rritur nivelin e bashkëpunimit më tej në kuadrin e Aleancës Euroatlantike.

Rreshter Bledar Blaceri

Atasheu ushtarak i Francës vizitë në Komandën e Forcës Ajrore

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj pra pak ditësh priti atasheun ushtarak të Francës (rezident në Romë), kolonel Daniel Venturi. Qëllimi i vizitës ishte zhvillimi i një takimi kortezie me rastin e emërimit të gjeneral brigade Vladimir Avdiaj në postin e komandantit të Forcës Ajrore. Gjatë takimit, kolonel Daniel Venturi uroi komandantin e Forcës Ajrore për detyrën e marrë dhe evidentoi bashkëpunimin e frytshëm që ka ekzistuar në realizimin me sukses të projekteve të përbashkëta në interes të modernizimit të Forcës Ajrore shqiptare.

Nga ana e tij, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj falënderoi dhe vlerësoi mbështetjen dhe kontributin e dhënë nga Forcat e Armatosura Franceze për



Forcën Ajrore Shqiptare në fushën e trajnimit të ekuipazheve fluturuese (pilot/teknik) dhe mbështetjen në fushën e mirëmbajtjes së helikopterëve Cougar. Në fund të takimit, nga të dy palët u shpreh dëshira e fillimit të projekteve të tjera në interes të modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore Shqiptare, duke synuar përmirësimin e standardeve të Aleancës.

Në kursin e Xhorxhias nëntoger Hekuran Budani ishte i vetmi shqiptar ndër 160 kandidatë që vinin nga emra shumë të njohur të shkollimit ushtarak si Ëest Point, ROTC, si dhe një ndër 13 ndërkombëtarët që ishin daluar në kompanitë e tyre gjatë trajnimeve të mëparshme. E paharrueshme ishte gjatë këtij trajnimi vizita në gjigandin mediatik CNN, aty ku në pjesën dërrmuese merr imazhin e plotë të saj vetë ushtria amerikane. E meqë kudo që nëntoger Budani ka marrë pjesë çmimet kanë qenë pjesë e pandarë e trajnimeve, edhe nga Xhorxhia nuk mund të largohet pa një trofe. Ai solli në atdhe bashkë me një eksperiencë të çmuar edhe çmimin e “Studentit Ndërkombëtarë më të Mirë të Togës”.



ETLEVA SMAÇI

Ushtarakë si nëntoger Budani janë aset i çmuar dhe nder i Forcave të Armatosura

Në Shqipëri profesioni i ushtarakut ka qenë mjaft i përhapur, sidomos përpara viteve '90, por duket se përjashtimet nuk kanë munguar dhe i tillë është edhe rasti i nëntoger Hekuran Budanit, në familjen e të cilit, madje as në farefisni askush nuk kishte qenë ushtarak. I lindur në kapërcyellin e viteve 80 dhe fillimit të 90-tës, kur profesioni i ushtarakut nuk bënte më pjesë tek ata profesione me anë të të cilit mund të siguroje shumëçka, ishte ndoshta arsyeja më e fortë e një familjeje për të mos rekomanduar fëmijën, djalë apo vajzë, në zgjedhjen e arsimit të lartë ushtarak. Po të kemi parasysh edhe faktin se Hekurani vitet e shkollës së mesme i kreu në një ndër kolegjet më elitare të posttranzicionit të arsimit shqiptar, në kolegjin “Mehmet Akif”, mund të jenë disa “pse” që kërkojnë përgjigje për zgjedhjen e tij? Nuk i u ofrua e drejta e studimit për një tjetër universitet shqiptar? Nuk kishte mundësi financiare ta ndiqte një të tillë? Përgjigjen na e jep vetë nëntoger Hekurani, ndërsa na kërkon të kthehemi në kohë gati 11 vite më parë, kur ai ishte vetëm 18 vjeç. Kolegjin “Mehmet Akif” e përfundoi me mesataren 9.4 dhe zotëronte në mënyrë të shkëlqyer anglishten, turqishten, italishten dhe pak gjermanisht. Pa vështirësi fitoi programin Financë në Universitetin e Tiranës. Por në biseda rastësore mes shokësh veshët i kishin zënë të flitej për një tjetër Universitet që po hapte dyert e tij për studentët e shkëlqyer nga e gjithë Shqipëria. Ishte Universitetit Ushtarak Skënderbej, që do të sillte i pari risinë e diplomimit të dyfishtë, një diplomë e Shkollës së Lartë Ushtarake dhe një diplomë civile në Financë, apo Inxhinieri Elektronike. Nuk u mendua gjatë, por vendosi ta “provonte fatin”, por në mënyrë pak të fshehur nga familja, të cilët nuk ishin shumë dakord që ai të bëhej pjesë e Forcave të Armatosura. Surpriza e kësaj pjesëmarrjeje ishte një stimul i fortë për rrugën që po niste. Nga 1600 nxënësit që aplikuan ai jo vetëm fitoi, por u rendit i parë ndër fituesit. Tashmë kishte nisur rrugëtimin e vështirë të



ushtarakut, duke mos u pënduar për “fatet” e lëna pas krahëve. Edhe në përfundim të studimeve akademike u shpall “Studenti më i mirë i kursit” dhe gjatë studimeve katërveçare shumë gjëra kishin ndryshuar faqe edhe në Forcat e Armatosura.

Vetëm pas një viti të përfundimit të studimeve, kur ai ishte në detyrën e tij të parë si komandant toge, Shqipëria u anëtarësua në NATO. Një ëndërr që shumë ushtarakë të tjerë karriere nuk mundën ta preknin, edhe pse kontributi kishte qenë madhor. I veshur ushtarak, me një punë jo me orar 8 orësh, siç mund të jenë shumë profesione të tjera, nëntoger Hekurani vendosi të qëndronte fort në dy shtyllat e shkollimit të tij,

ndaj me marrjen e diplomës Bachelor nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, vazhdoi studimet në nivelin Master Shkencor në Menaxhim të Përgjithshëm në Fakultetin e Ekonomisë Universiteti Tiranës. Kurse në shkollimin ushtarak profili i tij i përket oficerit të këmbësorisë. Por jo gjithmonë detyrat e para përkojnë me profilet e shkollimit. Detyra e parë që u ngarkua ishte ajo e komandantit të togës së zbulimit. Zbulimi e kishte grishur gjithmonë, por midis asaj idesë së një zbulimi të tipit alla Bond dhe zbulimit që gjeti në terren nuk kishte asgjë të përbashkët. Edhe pse gjatë kësaj kohe nuk mundi ta ushtronte profesionin në maksimum përse i bërkët punës në zbulim, ai mundi të zbulonte

ngarakuara pa pasur frikë se diku zhinxhiri do t'i këputej në ndonjë “hallkë të dobët”.

Thirrja për “Black Eagle”

Shkollimi perëndimor, në mënyrë të veçantë, shkollimi perëndimor pranë një institucioni arsimor ushtarak ishte një “ëndërr në sirtar” për nëntoger Budanin, por një ëndërr që e pa shumë shpejt të materializohej, kjo lidhur edhe me faktin, se nisja e karrierës së tij ushtarake përkoi me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Qëllimi i “Black Eagle” ishte të formonte trupën e oficerëve duke bërë një përzgjedhje shumë seleksionuese nga radhët e nënoficerëve, por

duket se mes kandidatëve pati edhe nga ata që tashmë ishin të diplomuar oficerë. Hekurani ishte një prej tyre. Kur e pyes përse e ndërmoreni këtë hap, ai modestisht më thotë: “Gjithmonë kam dashur të bëj diferencën, dhe kjo ishte një hap i parë për ta bërë këtë”. Nuk vonoi edhe rezultati i testeve pas një periudhe përgatitore 3 mujore në Shqipëri, ku përsëri e pa veten i pari dhe për këtë iu akordua medalja “Triumfatori i Kursit Black Eagle 001”. Mbërritja në bazën Fort Dix në Nju Xhersi ishte prekje e një ëndërr, por jo gjithmonë ëndërrat janë të bukura. Baza të sugjestiononte jo vetëm me ermin e saj të madh, por edhe për fakte të tilla se, prej bangave të saj kishin dalë me diplomën e Kursit të Oficerit figura të njohura politike e historike si Ajzhehauer. Po kaq mbreslënëse ishte motoja e saj: “Standarde pa kompromis/ Standarts not compromise”

Ishin plot 24 të rinj, që vinin nga Shqipëria me përvojë të ndryshme jetësore, profesionale, por të gjithë do të kalonin kalvarin e terapisë së shokut, ose siç instruktorët e shkollës e quanin “zhebërja e çdo vlere që kishin dhe krijimi i vlerave të reja të standardizuara”. Mbi të gjitha, ajo për të cilën Hekurani ndihet krenar ishte përgatitja për të mundur të bënte të vetat “Vlerën e Ushtarakut dhe Kodin e Nderit”, vlera më e lartë e USA-Army. E ndërsa këto vlera ditë e ditë i mblodhën, i përpunuan dhe i bënë pjesë të tyre, duket se sfida sapo kishte filluar. A do të mundesh ai së bashku me shokët e tij t'i bënin të tilla vlera pjesë të ushtrisë shqiptare? Edhe në përfundim të këtij kursi nëntoger Hekurani nuk mund të largohet pa një çmim të madh. Ky ishte “Çmimi i të dalluarit të grupit-Distinguished

Graduate Award”. Teksa e tregon emocionin në lidhje me marrjen e këtij çmimi, ai sjell një episod bisede tepër interesante me të atin.

“ I thashë prindërve të mi se edhe pas kthimit nga SHBA isha vlerësuar si më i miri i grupit. Në vështrimet e tyre ndesha një farë mosbesimi. Nuk vonoi dhe babai u shpreh me fjalët: “Po prap ti dole i pari? Nuk e zgjata shumë, por i ftova që të nesëmen të më shoqëronin në ceremoninë që do të organizohej për marrjen e këtij çmimi. Në përfundim të ceremonies, në lotët dhe përqaftimin e prindërve të mi, kuptova jo vetëm krenarinë e tyre prindërore, por edhe aprovimin për zgjedhjen që kisha bërë në moshën 18 vjeç për ndjekjen e shkollës ushtarake, pak në kokën time”. Sakrificat ime ia kishte vlejtur, unë isha shpërblyer jo vetëm me uniformën e ushtarakut, por kisha plotësuar shkollimin tim ushtarak në një ndër bazat më të fuqishme amerikane, siç është ajo në Neë Xhersi, një nder dhe fat që nuk mund të të ndodh pa punë. Ndaj në kthimin nga ky trajnim Hekurani vendosi të jetë përsëri pjesë e trupës. Pasi puna me trupat është për të një shkollë më vete, një eksperiencë që asnjë prej teorive nuk mund ta jepte apo të ta mësonte pa e prekur vetë.

Për herë të dytë në SHBA, Xhorxhia

Ndoshta për disa mund të quhet fat, kur lexon se nëntoger Budani në një moshë fare të re ka bërë disa trajnime ndërkombëtare, të afërta në kohë me njëra-tjetrën. Por në Forcat e Armatosura, anëtare të NATO-s fjala fat është sinonim i grupfjalëve meritë- punë-sakrificë. Si fitues i çmimit të “Studentit më të mirë” për grupin që përfaqësoi Shqipërinë në “Black Eagle 001”, atij iu akordua një trajnim pesëmuor në bazën e Këmbësorisë në Xhorxhia, ose siç njihet ndryshe “Shtëpia e Këmbësorisë”. Ky trajnim kishte në fokus krijimin e oficerit të leadershipit, pra ndërsa kursi i parë i futi në rrjedhën e jetës ushtarake përmes vlerave morale që janë principet e ushtrisë së sotme amerikane, kursi i dytë i dha profilin e një lideri të mirëfilltë në fushën e këmbësorisë. Për Hekuranin këmbësoria ngelet “mbreti” i çdo force dhe si për të na bindur sjell plot argumente mbi rolin e kësaj të fundit, sidomos në misionet paqeruajtëse, ku edhe vendi ynë është bërë pjesë. Pikërisht këto forca janë



të parat që marrin kontakt me njerëzit në terren, me nevojat e tyre apo gjatë rindërtimit të rajoneve që kanë qenë në luftim. E si për ta përmbyllur ai pohon se në ligjet e luftës, pushtimi quhet i realizuar vetëm kur “shkel këmba e këmbësorisë”. Në kursin e Xhorxhias nëntoger Hekuran Budani ishte i vetmi shqiptar, ndër 160 kandidatë që vinin nga emra shumë të njohur të shkollimit ushtarak si Ëest Point, ROTC, si dhe një ndër 13 ndërkombëtarët që ishin dalluar në kompanitë e tyre gjatë trajnimeve të mëparshme. E paharrueshme ishte gjatë këtij trajnimi vizita në gjigandin mediatik CNN, aty ku në pjesën dërrmuese merr imazhin e plotë të saj vetë ushtria amerikane. E megjë kudo që nëntoger Budani ka marrë pjesë çmimet kanë qenë pjesë e pandarë e trajnimeve, edhe nga Xhorxhia nuk mund të largohet pa një trofe. Ai solli në atdhe bashkë me një eksperiencë të çmuar edhe çmimin e “Studentit Ndërkombëtarë më të Mirë të Togës”.

Hoenfels, Gjermani, në fushën e stërvitjes

Prej prillit të vitit 2015, çdo mëngjes e gjen nëntoger Hekuran Budanin pranë Batalionit të Dytë të Këmbësorisë, Njësia 1020. E veçanta e kësaj njësie është shpallja e saj si njësi prioritare e Forcës Tokësore, NFR nga nivel kompanie deri në nivelin e batalionit. Në këtë kuadër, vetëm një muaj pas kthimit nga trajnimi në bazën e Këmbësorisë në Xhorxhia, e gjithë kompania ku bën pjesë nën-

toger Budani u nis për stërvitjen Kfor Rotation në Hoenfels të Gjermanisë. Shembulli i zgjedhur nga organizatorët e stërvitjes ishte një rast për Kosovën dhe situatat për të cilat kompania u stërvit dhe u vu në provë ishin menaxhimi i përbashkët i kufijve, menaxhimi i burimeve të medias, menaxhimi i turmave të irrituara etj. Si një stërvitje ku kompania shqiptare ishte e inkuadruar me një batalion amerikan, mbresat që sjellë ushtaraku shqiptar janë mjaft interesante. Puna me trupa i vendosën ata përballë stresit dhe emocionit, por asnjë prej tyre nuk u bë mbizotërues në realizimin e detyrës. Prandaj menjëherë erdhi ftesa për një tjetër stërvitje, “Combined Resolve”. Kjo stërvitje, e cila kishte në fokus operacionet e përbashkëta të NATO-s ka një vlerë të veçantë për certifikimin e Batalionit si NRF. Në këtë kuadër, 8 përfaqësues të kompanisë shqiptare, mes tyre edhe Hekurani do të bëheshin pjesë e “European Best Squadre Competition”, e organizua nga Komanda Ushtarake Amerikane në Europë. Ky konkurrim me një traditë të hershme kishte 10 vjet që nuk organizohej, ndaj rikthimi i tij jo vetëm që u prit me entuziazëm, por

pati edhe surpriza. E tillë u konsiderua edhe skuadra shqiptare, “skuadra surprizë e kompeticionit”, e cila u rendit e 10-ta ndër 18 vendet që garuan. Si një konkurrim skuadrash ushtarake vëmendja shkonte tek matshmëria e kapaciteteve të vendeve anëtare të NATO-s. Gara që zgjati tre ditë, ishte një garë që testonte limitet, që nuk



dallonte aspak nga ajo që ndodh në një fushëbeteje të vëtetë. Dhe muskujt nuk ishin të vetmit që vulosnin në fitoren e garës, por mbi të gjitha zotërimi i njohurive të NATO-s ishte çelësi i një gare të suksesshme.

Çdo fitore ka stimulim e saj. Në përfundim të garës Hekurani u ngarkua me detyrën e zëvendëskomandantit të kompanisë, një detyrë e merituar edhe pse organikisht nuk i takonte një e tillë. Stërvitje të tilla nuk kanë vetëm elementin ushtarak brenda tyre. Ato janë mundësia më e mirë e krijimit të marrëdhënieve të qëndrueshme njerëzore e miqësore. Duke pasur karakter multinacional, pasi në të morën pjesë rumunë, shqiptarë, gjergjorianë e bullgarë dhe stërvitja u drejtua nga ushtarakët rumunë, por gjithmonë në kuadër të NATO-s, nuk munguan edhe lindjet e miqësive të reja, shkëmbime të dhuratave simbolike, simbole të kombeve pjesëmarrëse apo simbole të njësisë që morën pjesë në stërvitje. Kompania shqiptare i dhuroi pjesëmarrësve simbolin e njësisë, Cobra Strike First, kurse në Batalionin e Dytë të Këmbësorisë ata

sollën si trofe certifikatën e falenderimit për pjesëmarrje.

Jeta akademike, synimi dhe sfidat Për të gjithë që e njohin, nëntoger Hekuran Budani merr shumë seriozisht çdo detyrë që i ngarkohet. Nuk ka rëndësi nëse ajo është një detyrë e rëndësishme apo një detyrë rutinë. I bindur se ka ende shumë për të mësuar, e ndien veten mirë pranë Batalionit të Dytë të Këmbësorisë dhe mendon se një eksperiencë trevjeçare me trupën do t'i vlejë për qëllimet e tij të ardhshme. Po të njëjtën gjë mendon edhe në lidhje me trajnimet që ka bërë. Nëse ato do t'i “ndrydh” vetëm për vete, një ditë ndoshta do të kthehen në të pavlera, prandaj sa herë ka kohë të lirë, ulet dhe sistemon gjithë njohuritë mara, duke iu dhënë trajtën e moduleve që shpeshherë i trajton me kolegët, me vartësit dhe do të dëshironte shumë që në të ardhmen t'i trajtonte me të rinjtë që do të vendosnin të ndiqnin karrierën ushtarake. Sepse ai është i bindur se në mes maturantëve të shkëlqyer nga mbarë Shqipëria ka shumë të tjerë, si ai, që mes dy zgjedhjeve asaj të një të drejte studimi për një shkollë civile dhe asaj për një shkollë ushtarake, do t'i thonë po pikërisht shkollimit ushtarak. Shembulli është ai

vetë Hekurani, që në pak se 10 vjet ka arritur të prek nga afër eksperiencat më të mira perëndimore. Forcat e Armatosura janë një portë e hapur drejt dijes, ato nuk janë aspak porta hermetike. Ato janë të parat porta që kanë ofruar Shqipërinë me aleancën më të madhe, atë të Atlantikut Verior duke e kthyer profilin e ushtarakut shqiptar të njëvlefishëm, po aq të respektuar sa edhe kolegët e tij kudo në Europë e SHBA. Hekurani, por edhe shumë djem e vajza të rinj që erdhën nga radhët e Universitetit Ushtarak, kanë qenë dhe ngelen një model mbi të cilin me të drejtë mund ngremë krenar imazhin e Forcave të Armatosura, pasi ata kanë bërë që emri i tyre të ngelet në faqet e nderit të Gardës Ushtarake të Neë Xhersit, në Kolegjin Britanik të Mbretëror Marinës etj. Ata janë aseti i Forcave të Armatosura që tek profesioni i ushtarakut kanë vënë dinjitetin dhe profesionalizmin e lartë. Ndaj dhe në faqet e gazetës “Ushtria” ata do të jenë kurdoherë miqtë e nderit, si nderi i Forcave të Armatosura.



Me rastin e 50-vjetorit të rënies në krye të detyrës

Niko Hoxha, piloti i përjetësisë ajrore shqiptare

Nënkolonel FIGALI GOLEMI
Dega e BCU, Komanda e Forcës Ajrore

Kujtesa e pilotëve ka bërë që të derdhnin në kujtimet e tyre të shkuarën e lavdishme të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Shpesh herë i drejtohen një emri, e thërrasin edhe “Babai i aviacionit shqiptar”. E kujtojnë atë burrë edhe pas gjysmë shekulli të rënë në krye të detyrës, si komandant, si mjeshër i fluturimit, si shok, si prind, si vëlla, si baba i aviacionit. Ai ishte dhe mbeti një “div” i aviacionit tonë ushtarak, shembull frymëzimi për shokët, kolegët, vartësit, njeri i çiltër me një trup të skalitur si të ishte atlet. Niko Hoxha, siç ishte i rregullt dhe tepër korrekt në repart, dallohej dhe për një regjim shembullor në jetë. Familja e tij përbëhej nga e shoqja, Jolanda, dy djemtë, Valeri dhe Sasha, të cilët i la para gjysmë shekulli dhe që historiografia ka gjithmonë për të folur, për të shkruar për jetën e Niko Hoxhës dhe dëshmorëve të aviacionit ushtarak. Kolonel Niko Hoxha dëshmonte aftësi të rralla organizative e drejtuese, zotëronte guxim e iniciativë, qëndronte në krye të punëve, të situatave e të aksionit, duke udhëhequr me stilin e një metodisti mjaft të mirë. Ai zbërthente e shpjegonte veprimet taktike me saktësi, elementët preciz të fluturimit, udhëhiqte fluturimet me përsosmëri e gjakftohtësi. Ju shpjegonte vartësve domosdoshmërinë e iniciativës, guximit dhe trimërisë së pilotit, si elementë të domosdoshëm, të cilët vendosin suksesin e fluturimit. Niko Hoxha ishte komandant që i “peshonte” hallet e njerëzve, me peshoren e logjikës së shëndoshë e me zemrën e një prindi. Ai ishte njeri i besës, tolerant e dashamirës si dhe nuk mbante mëri e nuk e njihte hakmarrjen. Realisht shokët dhe vartësit e tij nëpër vite e kanë gdhendur imazhin e tij si një njeri shpirtmirë e babaxhan, me një kulturë ushtarake të admirueshme, që e donte ushtrinë, forcën ajrore, rregullin e disiplinën dhe tregonte respekt për njerëzit me të cilët punonte. Ai ishte ushtarak i rrallë, korrekt e miqësor, pilot i talentuar dhe mbi të gjitha një “lokomotivë” e aviacionit shqiptar.

Legjendë e gjallë e aviacionit ushtarak shqiptar

Niko Selman Hoxha ishte lindur më 1 shkurt të vitit 1926 në fshatin Tragjas të rrethit të Vlorës, një fshat me traditë të shquara liridashëse. Arsimin fillor e mori në vendlindje dhe më tej ndoqi shkollën prestigjioze Normale të Elbasanit, por që me fillimin e luftës, e la shkollën dhe ngjeshi armët për lirinë e atdheut. Që në vitin 1942 u lidh me njësitet guerile dhe më pas në çetat territoriale. Më 3 qershor 1943 u bë pjesëtar i çetës së rinisë Gumenicë. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në Malin e Bardhë, në Jonufër, në Drashovicë etj. Me krijimin e Brigadës së Pestë Sulmuese, Nikos i ngarkuan detyrën e zëvendëskomisarit



të kompanisë më pas përgjegjës rinie batalioni. Kur Br.V S kaloi në veri, në Kosovë dhe më tej, deri në Sanxhak, ai mbante detyrën e përgjegjës të rinisë të Brigadës, duke shfaqur aftësitë e tij të veçanta, si në luftime, ashtu dhe në marrëdhënie me partizanët, luftëtarët e lirisë. Pas çlirimit, Nikon e dërguan për studime në Akademinë e Aviacionit në Saratov të BS, që e kreu gjatë viteve 1945-1948. Më tej, në vitet 1949-1952 mbaroi studimet në Fakultetin e Komandimit të Forcave Ajrore në Moskë të Bashkimit Sovjetik. Pas mbarimit të shkollave për aviacionin, u kthye në atdhe dhe u emërua komandant i Skuadriljes së Parë Luftarake shqiptare. Por përsëri shkon për specializim, për avionët reaktiv “Mig-15”, në qytetin Grozni. Në verë të vitit 1955 u emërua komandant i Regjimentit të Parë të Aviacionit në Kuçovë, ndërsa në vitin 1962 Niko Hoxha u emërua komandant i Regjimentit të Rinasit, ku drejtoi deri në ditën e rënies në krye të detyrës.

Piloti i talentuar tragjasiot, koloneli i aviacionit Niko Hoxha, ra në krye të detyrës më 20 nëntor 1965, në aerodromin ushtarak të Rinasit, në kuadrin e zhvillimit të një qitje luftarake me aeroplan reaktiv të tipit “MIG-17 F”.

Tragjedia ndodhi përpara efektivëve të regjimentit dhe ushtarakëve të Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm. Ja si përshkruhet momenti i rënies së dëshmorit në monografinë: “Piloti legjendë që bëri histori” me autor Niazi Nelaj: “.u nda nga jeta, aksidentalisht dhe heroikisht, në krye të detyrës, piloti i talentuar, nga Tragjasi i Vlorës, njëri nga themeluesit dhe organizatorët më të përkushtuar të aviacionit luftarak shqiptar, piloti i klasit të parë, koloneli i aviacionit Niko Selman Hoxha. E shtuna e fundit e nëntorit të vitit të largët 1965, kur kalendari ditor shënonte 20, në orën 10, në fundin Jugor të aerodromit ushtarak të Rinasit, sot aeroporti “Nënë Tereza”, në prani të efektivëve të regjimentit dhe disa oficerëve të Akademisë Ushtarake, ndodhi ajo që nuk besohej, ngjarja e rëndë ajrore, e cila përfundoi me katastrofë. Në atë katastrofë ajrore, “u shua” jeta e njërit nga pionierët e aviacionit shqiptar, trimi i çartur, Niko Selman Hoxha”.

Ja edhe një version tjetër që është krejtësisht i përputhshëm me të parin: “Komandant Niko Hoxha, u shpjegoi akademistëve të dhënat teknike dhe cilësitë luftarake të “Mig 17” dhe pastaj dha urdhër që çifti i avionëve

”

Sot mbushen plot 50 vjet nga dita e rënies në krye të detyrës të Niko Hoxhës, këtij piloti të talentuar që është bërë tashmë simboli i aviacionit luftarak shqiptar, një emër që ka hyrë në histori deri në pavdekësi. Aviacioni luftarak shqiptar është i lidhur pazgjidhshmërisht me emrin e tij. Atje, në kaltërsinë e pafundme të qiellit shqiptar Niko Hoxha u rrit, u burërua dhe u bë shqiponjë në mbrojtje të kësaj hapësire. I tillë ka mbetur edhe tani pas pesëdhjetë viteve dhe po kështu do të jetë edhe...në përjetësi.

të dilte në pistë, në gatishmëri për luftim. Hipi vetë në njërin prej tyre. Ai u ngrit nga pista fluturimthi, çau retë e dendura drejt qiellit. Pas pak minutash, befasisht kaloi fare ultazi, sa nuk preku çatitë e ndërtesave, duke lënë pas një zhurmë trishtuese. Pastaj u ngrit sërish lart, duke mos kapërcyer



retë bëri disa figura të vështira taktike, që rrallë pilotë në botë mund t'i bëjë. Ai e manovronte lehtësisht avionin si mjeshër i manovrimit me avion reaktiv dhe tepër i guximshëm. Herën e fundit ai bëri një pikiatë pingule mbi pistë dhe iu afrua rënies, bishti i avionit i takoi në pistë dhe avioni në çast mori flakë. E nxorën nga flakët trupin e tij të pajetë dhe një gjëmë e madhe e pushtoi Rinasin, repartet e aviacionit dhe gjithë ushtrinë. Kish ndërruar jetë piloti i famshëm, komandanti i shquar, krenaria e aviacionit luftarak shqiptar. Ismail Kadare atëherë shkroi këto vargje:

*Ti e deshe kaq shumë këtë tokë,
Në stërvitje shpejt i aviteshe,
Më të tmerrshëm shpejtësi!
Një ditë, kaq shumë,
Në pikiatë iu afrove,
Sa zgjati dorën dhe të mori në gj!*

Tridhjetë vjet pas rënies komisioni qeveritar i statusit të dëshmorit e shpalli Niko Hoxhën “Dëshmor i Atdheut”, ndërsa shkollës së Valiasit iu dha emri “Niko Hoxha” në vitin 1968; Regjimentit të Aviacionit në Rinas iu vendos emri “Regjimenti Niko Hoxha”, Bashkia e Kuçovës e ka shpallur “Qytetar





Nderi” të saj. Niko Hoxha është dekoruar me 12 urdhëra e medalje si “Medalja e Trimërisë”, “Medalja e kujtimit” “Urdhëri i Skënderbeut”, “Medalja e 10 vjetorit të çlirimit” etj.

Dhe Niko Hoxha, legjenda e aviacionit tonë ushtarak, i meriton të gjitha këto vlerësime.

Fillimet e fluturimeve në roje të hapësirës ajrore shqiptare

Pikënisja e fluturimeve të para u bë me avionët të mbetur nga Lufta e II Botërore prej pushtesve italianë. Eksperimente pilotësh shqiptarë të përgatitur me kurse disa mujore në ish-Jugosllavi. Më pas u përdorën disa avionë nga ushtria ish-jugosllave, ish-sovjetike dhe kineze, të cilat kanë historikun e tyre me emra e data në muzeun ushtarak dhe në memorien ushtarake dhe atë kombëtare. Përgatitja nëpër shkollat e ish-jugosllave, ish-sovjetike dhe kineze e aviatorëve tanë të talentuar pati veçoritë dhe rezultatet e veta, prej një sakrifice që vlen të cilësohet. Ngritja e aviacionit shqiptar shoqërohet me rrugën politike të marrëdhënies politike. Kështu, së pari, në kuadrin e Traktatit të Varshavës, së dyti në marrëdhëniet shqiptaro-kineze dhe së treti

pas prishjes me kinezët u mbështetëm te “forcat tona”, duke i përgatitur aviatorët në Shkollën e Aviacionit në Vlorë. Çështja historike në aviacion ka këndshikimin e aviatorëve tanë si heronj dhe dëshmorë të vendit. Për heronj dhe dëshmorë është folur dhe shkruar, duke publikuar në çdo jubile festiv apo në çdo përvjetor ushtarak, aq sa i janë kushtuar libra, filma e poezi, deri sa kanë ushqyer ndjenjën e shumë shqiptarëve për t’u bërë aviator. Por arma e aviacionit kishte vështirësitë e shumta dhe rrugën e saj të gjatë të mbushur me dëshmorë, që mbart brenda lavdinë, kompleksitetin dhe problematikën e teknologjinë e kohës. Fluturimeve në roje të hapësirës ajrore shqiptare i dhanë jetë mbi 300 pilotë shqiptarë, djem të përgatitur për mbrojtjen e hapësirës qiellore shqiptare. Në pamundësi për të përmendur të gjithë këtë armatë pilotësh po shënojmë emrat e disa prej tyre si: Edip Ohri, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Gëzdar Veipi, Peço Polena, Perlat Binaj, Salih Dibra, Haki Jupasi, Stefan Kagjini, Lulo Musai, Mahmut Hysa, Koço Andoni, Vasil Andoni, Refat Kasimati, Foto Lako, Harilla Rebi, Fari Bubsii, Astrit Jaupi, Gëzim Ismaili, Fatmir

Zyfi, Ismet Zervoi, Fatmir Meçe, Agim Matraku, Alfred Tafa, Martin Bregu, Raqi Qari, Vladimir Avdiaj, Altin Lama, Kuto Hasani, Faslli Spahiu, Balil Hyseni, Agim Sallaku etj. Tw gjithç kçta, ashtu si dhe të gjithë pilotët e tjerë të Forcës sonë Ajrore kanë qenë dhe janë krenaria e Forcave të Armatosura Shqiptare.

Kronika gjysmëshekullore e aviacionit ushtarak shqiptar

Emëri i Niko Hoxhës lidhet ngushtësisht me historinë më se gjysmë shekullore të aviacionit ushtarak shqiptar. Dhe kjo jo vetëm si një ndër pilotët e parë ushtarak, jo vetëm si një nga themeluesit e kësaj arme dhe si një nga komandantët i lavdishëm, por edhe si promotor i progresit të saj. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik vështirësi të mëdha do të kalonte edhe aviacioni luftarak. Karburanti ishte ndër çështjet urgjente. Pas përpjekejeve që bënë inxhinierët dhe teknikët tanë u arrit të prodhohej karburanti special për avionë ushtarak,

por ai duhej provuar. Dhe do të ishte Niko Hoxha ai do ta merrte përsipër këtë detyrë të vështirë. Ai bëri trimërinë e radhës, kaloi “provën e zjarrit” kur u çua në ajër me një aeroplan reaktiv të furnizuar me karburant të prodhuar në uzinat shqiptare. Fitorja në këtë rast matej me rritjen e autonomisë të aviacionit tonë. Fluturimet, tashmë nuk do të varehin nga importi i karburantit prej Bashkimit Sovjetik, avionët do të ngriheshin në ajër falë cilësive të larta të karburantit tone, i cili ishte edhe më i sigurtë. Prandaj shpesh brezi i aviatorëve që fluturonte para një gjysmëshekulli thoshte: “Niko Hoxha e “ka marrë për dore” aviacionin shqiptar, që është një përfundim krejtësisht i saktë dhe i bazuar”. Një pilot shqiptar ishte krejtësisht konkurrues me një

mjeshtër fluturimesh të NATO-s, apo të Traktatit të Varshavës, si dhe kishte një tjetër avantazh: vetëmohimin për detyrën e tij nuk e kishte nga nxitja e parave. Shtojmë se avioni që ngrihej 6 herë në ditë me një pilot duke bërë për çdo ngritje nga 30-40 minuta, ishte pikërisht MIG-19, që, në disa vende të bllokut të Lindjes, pilotët e cilësonin “flying coffin”. Aviacioni ushtarak shqiptar ka pasur rrugën dhe historinë e tij të suksesit, që në përbërje të tij ka pasur një flotë ajrore të konsiderueshme aq sa në vitet ’80-të shkoi në rreth 240 mjete ajrore avionë dhe helikopterë, përfshi edhe mjetet ajrore mësimore. Për më shumë se tre dekada ka funksionuar Shkolla e Forcave Ajrore e themeluar zyrtarisht më 11 maj 1962. Në vitin 1971 ajo u emërtua “Shkolla e Lartë e Aviacionit” me vendimin e Këshillit të Mbrojtjes, në 1992 mori emrin Akademia e Forcave Ajrore, ndërsa në 2005 u quajt Shkolla e Trupës së Forcave Ajrore dhe në vitin 2008 kjo shkollë kaloi në varësi të KDS. Pas vitit 1992 studentët për pilot u dërguan në jashtë vendit në akademitë e Italisë, Turqisë, Greqisë, SHBA-së, Gjermanisë, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Ndërkohë që historia më e re e aviacionit është ajo e pajisjes me mjete të reja si: më 24 prill 2004 erdhi helikopteri i parë AB-205; më 1 shkurt 2007 erdhi helikopteri për transport VIP A – 109; më 18 qershor 2007 erdhen helikopterët e parë BO – 105; më 28 korrik 2012 erdhi helikopteri EC-145, i versionit VIP; më 3 dhjetor 2012 erdhi helikopteri i parë shumëfunksional COUGAR, që u pasua edhe me dy helikopterë EC-145 mw 31 tetor 2015. Gjithë zhvillimi dhe progresi është edhe ëndërra e ish-pilotëve ushtarakë që shkruanë jetën e tyre në shërbim të armës

rast shkuam të bënim bombardim në Divjakë. Elementët e bombardimit nisin që në klasë, që në aerodrom, vazhdojnë te manovrat e hyrjes për hedhjen e bombave dhe finalizonin në hedhjen në shenjë të eksplozivëve të mbarsur me vdekje. Një pilot luftarak, duhet të përgatitet në situatë të ngjashme me luftën dhe këtë, ish partizani trim e dinte krejt mirë. Kështu Niko Hoxha ndodhej në lartësi të madhe mbi rajonin e objektit që do t’i nënshtrohej bombave të pilotëve të shkollës së tij. Në atë lartësi ai vërente ardhjen tonë me kujdes për të bërë më pas një analizë sa më shkencore të realizimit të detyrës, bombardimit... Në kushtet kur kishim kaq dendur provokacione ajrore nga fqinjët tanë... Kësi fluturimesh intensive aviacioni ynë luftarak ka bërë sidomos në situata kërcënuese. Me 29 nëntor të vitit 1964 është organizuar parada më e madhe e aviacionit, ku parakaloi tërë parku i aeroplanëve shqiptarë duke kaluar në të njëjtën kohë nëpër qiellin mbi sheshin “Skënderbej”. Bombarduesin e vetëm që kishte Shqipëria, IL-28 e pilotit të shquar Bajram Hida, e shoqëronin 12 avionë MIG-15 të ardhur nga Kuçova, 12 avionë MIG-19, të Rinasi të drejtuar nga piloti Lulo Musai dhe 11 avionë MIG-17 të drejtuar në ajër nga Niko Hoxha. Por populli nga poshtë nuk kishte se si të shquante mes këtyre të njëmbëdhjetëve, edhe një që ndryshonte paksa nga ata. Ishte një spark MIG-15, një avion dy vendesh mësimor, sepse një vit më parë, me 17 qershor 1963, një MIG-15 që rrëzuar bashkë me dëshmorin e aviacionit shqiptar, Sokrat Basha. Kështu që numri për paradën e 20- vjetorit të çlirimit u plotësua pikërisht me MIG-15.

Ish-piloti, bashkëkohës, Bajram Hitaj: Kur ishim me studime në ish-



së tyre të dashur, aviacionit ushtarak.

Përjetësisht në altar të atdheut dhe në zemër të shokëve

Në aviacion kanë rënë në krye të detyrës 36 “Dëshmorë të Atdheut” dhe moshë mesatare e tyre është 31 vjeç. Dëshmorët e aviacionit prehen bashkë, në ritmet e marsheve të përjetësisë, në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, aty ku vargjet e himnit tonë kombëtar, “po vdes, po vdes, si një dëshmor”, marrin një kuptim real e krejt të veçantë. Dhe në krye qëndron komandanti i tyre Niko Hoxha. Në këtë përvjetor jubilar të rënies së Niko Hoxhës ne zgjodhëm dy “dëshmi” nga pilotët që kanë mësuar prej tij dhe kanë punuar me të.

Ish-piloti Andrea Toli: Rinasi komandohej nga Niko Hoxha. Në një

Bashkimin Sovjetik, Niko Hoxha brenda një kohe të shkurtër, na u bë shok, vëlla, prind dhe mësues. Na rrinte afër, na mësonte dhe na edukonte për jetën; na ndihmonte në mësim, se nuk dinim asnjë fjalë rusisht, na mësonte dhe si të silleshim. Ne qëndruam së bashku 1 vit. Ai u kthye në Shqipëri e më vonë vajti në Akademinë e Aviacionit, në Moskë, e cila ishte shkollë ku përgatiteshin drejtuesit e armëve e shërbimeve të ushtrisë...Gjatë vitit 1951 Niko Hoxha dhe piloti Edip Ohri, studionin në Akademinë e Drejtimit të Aviacionit, në Moskë. Duke ndjekur studimet akademike në Moskë, të dy shkuan në aerodromin e qytetit të Novosibirskut të Bashkimit Sovjetik, ku bënë kalimin në aeroplanët gjuajtës, me helikë JAK-9P, me të cilët u furnizua aviacioni shqiptar...



Për një reflektim ndaj veprimeve terroriste në Paris



NËN/KOL (R) MSC KANAN HIMAJ
Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit

Terrorizmi, si shfaqje e dhunshme ndaj njerëzimit, shfaqje me peshë të madhe në të gjitha veprimtarinë shtetërore dhe shoqërore, është sot tema e ditës. Në veçanti është kryefjala që lidhet me ngjarjet e ndodhura para pak ditësh në Paris, në simbolin e demokracisë, ku për shkak të errësirës së mendjeve të terroristëve humbën jetën shumë njerëz të pafajshëm, pse ata gëzonin lirinë e tyre.

Revista e përvitshme "Index Terrorism Globale - 2015", botim i Institutit për Ekonomitë dhe Paqen thekson se terrorizmi vazhdon të rritet. Shifrat janë në nivelet më të larta të regjistruar ndonjëherë. Shumica e konsiderueshme e këtyre vdekjeve kanë ndodhur kryesisht në disa vende si: Irak, Nigeri, Afganistan, Pakistan dhe Siri. Ndërsa terrorizmi është përqendruar në disa vende, numri i vendeve që kanë pasur një sulm terrorist është gjithashtu në rritje. Sulmet janë regjistruar në 93 shtete, nga 88 që ishin në vitin 2013. Por, kriminaliteti dhe numri i veprimeve të dhunshme janë rritur në masë të madhe në ditët e sotme, e cila siç shënuam më sipër është temë e ditës. Filtrimi i terroristëve nga vendet me probleme të mëdha, siç janë vendet e Lindjes së Mesme apo ISIS, në kushtet e emigrimit për shkak të luftës në Siri dhe gjetkë ka vendosur në vështirësi të mëdha shumë shtete të Perëndimit. Më tej, ngjarja e Parisit solli përsëri në vëmendje të opinionit ndërkombëtar edhe praninë e shumë terroristëve me vendlindje, vendbanim, me moshë të re, njohës të mirë të vendit ku vepronjë, që flasin mirë gjuhën e vendit ku jetojnë dhe me aktivitet në vendet e origjinës.

Vendi ynë, me botën e vetë të shpirtit njerëzor është rreshtuar gjithmonë në krahun e duhur të vendeve dhe shoqërive demokratike. Shqipëria vijon të bëhet pjesë e pandarë koalicionëve për të luftuar të keqen e shoqërisë. Interesat dhe objektivat e vendit tonë janë të mbështesin njerëzit e vetë dhe të kontribuojnë përtej kufijve shtetëror



me kontribute reale për sigurinë dhe mbrojtjen. Strategjia e Sigurisë së RSH thekson se: "Shqipëria është përherë e më e integruar në një botë komplekse dhe të ndërvarur, ku rreziqet e brendshme dhe të jashtme janë të lidhura ngushtë. Përballja me këto rreziqe kërkon një qasje kombëtare dhe të integruar, që vë në përdorim burimet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FA), agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve inteligjente".

Mbrojtja jonë dhe në këtë kuadër, Ministria e mbrojtjes dhe shtabi i Përgjithshëm, janë ndër të parat që ndjenë peshën e përgjegjësisë, si një ndër institucionet e sigurisë së vendit. Tashmë, në ditët e sotme, duhen bërë vlerësimet e duhura për të reaguar në kushtet e reja të situatës duke nxjerrë mësimet ndaj vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme. Nuk mund të mos vlerësohen deklaratat e shumë udhëheqësve shtetëror në botë, në veçanti presidentit



"Shqipëria është përherë e më e integruar në një botë komplekse dhe të ndërvarur, ku rreziqet e brendshme dhe të jashtme janë të lidhura ngushtë. Përballja me këto rreziqe kërkon një qasje kombëtare dhe të integruar, që vë në përdorim burimet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FA), agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve inteligjente".

të Francës, i cili thotë: "Sulmet terroriste janë një akt luftime". Nisur sa më lartë në kushtet e vlerësimit strategjik mund të përmendim edhe deklaratën e ish-presidentit Sarkozy, i cili, midis të tjerash, thekson: "Nuk dua të mbajë asnjë qëndrim politik, kemi shumë dhimbje". Jo si rastësisht sjellë në vëmendjen e lexuesve këtë deklaratë, pasi ajo tregon unitetin, forcën e një kombi, i cili bashkohet për të kapërcyer një fatkeqësi. Kjo është një çështje që duhet



të shkojë në analogji të drejtë edhe për politikën e diplomacinë tonë. Nuk ka se si të mos ketë ndikimin e vetë edhe në masat efektive për të reaguar nga forcat e sigurisë dhe të mbrojtjes sonë.

Duke u rikthyer në analizën e ngjarjeve të ndodhura të kohëve të fundit, ato tregojnë se janë të planifikuara mirë, ku organizimi e ka zanafillën si brenda dhe jashtë vendit. Me këtë duam të theksojmë se elementët e veprimeve të dhunshme, të cilat nuk mund të përjashtohen edhe në vendin tonë, mund të krijojnë spektrin e plotë ose të pjesshëm për një veprim terrorit me përmasa serioze që të vërë në pozita të vështira shtetin dhe shoqërinë tonë. Veç forcave të tjera të sigurisë së vendit, ushtria me forcën e saj ka aftësitë të bëjë vlerësimin e veprimeve të tyre. Ajo ka forcën dhe ekspertizën të bëjë analizën e duhur. Prandaj dua të theksoj se këto vlerësime në stafet e FA kërkojnë një vëmendje më të madhe duke u larguar nga të menduarit sipërfaqësor dhe të futen më mirë në fenomenet e luftës hibride, duke marrë pjesën e angazhimeve të forcave.

Terrorizmi e ka përshtatur veten për kushtet dhe mundësitë e reja. Në shekullin e 20-të objekti i veprimeve terroriste u përfaqësua nga persona të veçantë. Këto sulme kanë pasur objektiv kryesor prodhimin e ankthit të popullsisë nga ekzistenca e një kërcënim ndaj sigurisë individuale, familjen e tij (një kërcënim për shëndetin apo të jetës). Paniku apo frikësimi vendoste në presion klasën udhëheqëse të shtetit, organizatave dhe kategorive sociale. Terroristët, duke u përpjekur për të arritur objektivat e tyre, për një ideologji të caktuar ose subjekt, e kanë çuar më tej luftën e tyre. Në ditët e sotme forma të reja të terrorizmit janë



në fokus të tilla si, goditjet e shpejta të grupeve terroriste dhe sjella e shumë humbjeve të jetës njerëzore ose materiale, veprime të luftës kibernetike, bioterroriste, dhuna në formën e presioni psikologjik të shoqërisë, grabitja dhe krijimi i ekonomisë së pronës pa baza dhe shfrytëzimi i saj për veprime terroriste etj.

Këto dhe të tjera forma hibride të luftës shpesh nuk vlerësohen si akte terroriste, si veprime të sakta me profil profesional. Nga ana tjetër ata përgatiten të mos kenë mëshirë dhe të vrasin njerëz të pafajshëm, pa dallim grup moshe, race apo kombësie. Këto grupe terroristësh profesionistësh vendosin të drejtën e moralit të tyre mbi gjithçka, qëllimin për të përhapur doktrinën gjoja fetare, siç ngjet me

atë islame.

Në këtë kontekst do të ishte me interes studimi dhe vlerësimi mbi rreziqet e mundshme që mund të vijnë në Shqipëri dhe në bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile të krijuhet një perceptim sa më i qartë nga publiku mbi faktorët e rreziqeve, për vlerësimin e sigurisë kombëtare ndaj fenomenit në rritje të terrorizmit, si një rrezik edhe për ne. Në këtë aspekt, duhet pranuar se terrorizmin e ndihmojnë dhe e bëjnë faktik edhe problemet e shumta ekonomike.

Strategjia Ushtarake RSH - 2015 thekson se terrorizmi përbën kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin ndërkom-bëtar. Tensionet rajonale, të ndikuara edhe nga faktorë të tjerë ideologjikë,

politikë, fetarë dhe kulturorë, mund të frymëzojnë grupe ekstremiste, të cilat synojnë përhapjen e ideologjive ekstremiste dhe ndërmarrjen e akteve terroriste në zonën euroatlantike, përfshirë Republikën e Shqipërisë. Sot, më shumë se kurrë, veç sa më lartë, kërkohet përballja me terrorizmin me të gjitha mënyrat dhe mjetet për të triumfuar mbi të. Planet tona, si edhe në mbrojtje, kërkohet të jenë fleksible, të plota, me parashikime të skenarëve, me masa konkrete duke përfshirë të gjithë llojet e forcave, secili në mënyrën e vetë, sipas specifikës dhe misionit. Bashkëpunimi i vendosur mbi baza ligjore për luftën kundër terrorizmit të përfshijë në planet institucioneve të sigurisë problematikën e sotme dhe pritshmërinë e së



ardhmes për elementët që rrezikojnë sigurinë. Kështu mund të përmendim të ashtuquajturit "luftëtarë" në krahun e shtetit ISIS, ku dihet se nga vendet e Ballkanit, përfshi edhe Shqipërinë, ka shumë persona të angazhuar në këtë front dhe që me veprimet terroriste kanë kërcënuar edhe vendit tonë.

Nisur nga mësimet e nxjerra të njohjes së situatave dhe veprimeve terroriste në botë mund të theksojmë se ato nuk kanë kufi dhe fushë të përcaktuar, por tashmë ato janë bërë shumë të rre-zikshme për shoqërinë tonë. Duam të theksojmë se ato nuk kanë përcaktimin e kufijve gjeografik, si të tilla mund të futen edhe në vendin tonë, të cenojnë sigurinë me veprime terroriste siç mund të jenë: sulme me eksploziv në grumbullime urbane; sulme me agjentë patologjike; sulme ndaj objektivave që mund të ndikojnë në ekonominë kombëtare; rritjen e numrit të veprimeve për të marrë financa nga kompani private ose shteti; bashkëpunim i grupeve terroriste me grupet e krimit të organizuar dhe rritja e aktivitetit me bazë fetare etj. Pra, aspekt i veçantë në tërësinë e problematikës është shkëmbimi i informacionit për njohjen e gjendjes brenda strukturave të sigurisë së vendit, por edhe jashtë saj. Në një vështrim të përgjithshëm në jetën e përditshme ende ndihet mungesa e shkëmbimit të informacionit dhe të vlerësimit të tij si një faktor i rëndësishëm për rritjen e

ndjeshmërinë të organizmave përkatëse. Në këtë kuadër, fusha e veprimit për veprime kërkon rivlerësimin e objekteve të rëndësishme strategjike, por edhe të aktivitetit të shoqërisë civile si, porte, aeroporte, stadione, rrugë, vende frekuentuese të aktiviteteve kulturore etj. Këtu gjenë veten dhe dalin detyra për FA, sidomos në ruajtjen dhe sigurinë e objekteve të rëndësishme, pjesëmarrjen në operacione mbështetëse të forcave të veçanta me status ligjor ndaj terrorizmit me zgjidhje të për-bashkëta etj.

Disa drejtime kryesore të zhvillimit të aftësive luftarake të FA për luftën kundër terrorizmit duhte të orientohen drejt efektivitetit të elementëve kyç si personeli, materialet, objektet, doktrinën, organizimin, lidhshipin, trajnimin dhe ndërveprimin (DOTMLPFI). Bazë e punës për zhvillimin e aftësive të forcave duhte të jenë qëllimet/synimet e reja të aftësive të tyre, duke e realizuar më shpejt transformimin në fushën e përgatitjes dhe gatishmërisë të tyre. Baza e aftësive të jetë përgatitja për veprime luftarake nga forcat tokësore (këmbësoria e motorizuar) dhe operacionet me forcat special, në bashkëpunim me forcat e tjera dhe në përshtatje me mundësitë, misionin dhe detyrat specifike në përputhje me natyrën e veprimeve terroriste. Aftësitë e forcave të shërbejnë si bazë për detyrat të bazuara në repartet prioritare. Ndërsa mbështetja luftarake të bazohet në mbështetjen me zjarr, aftësitë xhëniere, mbrojtjen civile, policinë ushtarake, aftësitë detare, aftësitë e zbulimit dhe inteligjencës etj.

Sigurisht, me këto që cekëm dhe trajtuam më sipër, nuk pretendojmë se trajtuam në mënyrë të plotë këtë çështje kaq të rëndësishme dhe delikate, por është e dukshme se puna ka nisur për tu thelluar më tej në proceset e planifikimit dhe mbështetjes së kundërvënies dhe luftës kundër fenomeneve terroriste, të cilat rre-zikojnë lirinë dhe sigurinë e shoqërisë tonë. Në shërsbim të këtyre masave dhe të kësaj pune janë dhe porosinë e fundit që ka dhënë ministrja e Mbrojtjes Kodheli në ceremoninë prezantuese të komandantëve të rinj në Forcën Tokësore dhe në atë të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, e cila ndër të tjera theksoi, që të zhvillohen më shumë projekte për fenomenet negative që kërcënojnë sigurinë, sidomos ato të natyrës së luftës hibride.



Terrorizmi përbën kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin ndërkom-bëtar. Tensionet rajonale, të ndikuara edhe nga faktorë të tjerë ideologjikë, politikë, fetarë dhe kulturorë, mund të frymëzojnë grupe ekstremiste, të cilat synojnë përhapjen e ideologjive ekstremiste dhe ndërmarrjen e akteve terroriste në zonën euroatlantike, përfshirë Republikën e Shqipërisë.

Është koha për të investuar në mbrojtjen tonë

MIMOZA GOLIKJA

Në ditën kur kombet e NATO-s dhe BE-së treguan solidaritet, forcë dhe vendosmëri në vazhdim të Parisit, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg bëri thirrje për NATO-n dhe BE-në për të punuar edhe më afër së bashku. Në një fjalim në Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes më 16 nëntor 2015, në konferencën vjetore të Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (EDA), Sekretari i Përgjithshëm paraqiti tri fusha ku dy organizatat duhet të bashkëpunojnë më ngushtë, duke përfshirë kërcënimet hibride, mbështetjen e partnerëve dhe inkurajimin e një industrie konkurruese evropiane të mbrojtjes dhe të sigurisë.

Pjesëmarrësit e konferencës mbajtën një minutë heshtje për të nderuar viktimat e sulmeve terroriste në Paris më 13 nëntor 2015. Në dritën e këtyre ngjarjeve tragjike, diskutimit për mbrojtjen evropiane i është dhënë një dimension shumë realist, duke dëshmuar se mbrojtja Evropiane përbën një çështje të rëndësishme. Në fjalën e tij Sekretarri i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pasi falenderoi të pranishmit dhe Federica Mogherinin, Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, për prezencën, për fjalën e hapjes, “sepse si gjithmonë na jep më shumë njohuri dhe të kuptuarit më të mirë të çështjeve shumë të rëndësishme dhe shumë e komplikuar si dhe për sfidat me të cilat përballemi së bashku”. Ai bëri thirrje për një bashkëpunim më të ngushtë NATO-BE me qëllim për të forcuar më shumë sigurinë. Stoltenberg tha se “Sot ne takohemi në një ditë të dhembjes dhe solidaritetit për Europën. Në mesditë sot, në NATO, në BE, dhe në të gjithë kontinentin, ne qëndruam për një minutë heshtje. Në kujtim të viktimave të sulmeve barbare të së premtes në Paris. Ne i dënojmë këto sulme në mënyrën më të fuqishme”. Ai tha se ato përfaqësojnë një sulm mbi vlerat tona themelore të lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

“Objektivi i tyre ishin njerëzit e zakonshëm gjatë kënaqësisë së tyre të një nate të premtë në një nga qytetet më të mëdha të botës, në një koncert, në një ndeshje miqësore futbolli, dhe në kafene”. Stoltenberg tha se sulmet të tilla janë menduar për të trembur, “për të na trembur, por ato vetëm sa do të forcojnë vendosmërinë tonë. Kjo nuk është një luftë në mes botës Muslimane dhe Perëndimit. Kjo është një luftë midis ekstremistëve dhe atyre që besojnë në vlerat themelore të lirisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut”. Ai tha se “muslimanët janë duke udhëhequr këtë luftë kundër ISIL, në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut, pasi ata kanë vuajtur shumicën e viktimave. Terrorizmi dhe ekstremizmi nuk mund të mposhtë demokracinë dhe shoqëritë tona të hapura. Ata nuk do të ndryshojnë kush jemi dhe se si ne e jetojmë jetën tonë. Ne do të dyfishojmë përpjekjet tona dhe të punuar edhe më ngushtë, si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë ndërkombëtare për të luftuar ekstremizmin dhe terrorizmin”.

Më tej ai vazhdoi se “ne duhet të qëndrojmë vigjilentë, të vendosur, dhe të

bashkuar. Lufta kundër terrorit është edhe një shembull se si NATO dhe Bashkimi Evropian janë partnerë të natyrshëm. Ne ndajmë të njëjtin rajon. Ne ndajmë të njëjtat sfidat komplekse të sigurisë. Ne ndajmë 22 shtete anëtare”. Stoltenberg tha se 9 nga çdo 10 qytetarë të BE-së, jetojnë në një vend të NATO-s. Çdo ditë, ne shohim se si jemi të ndërlidhur dhe sesa e ndërlidhur është siguria jonë. Se si problemet në njërin pjesë të botës, ndikojnë tek njerëzit në pjesën tjetër”.

Reagimi i bashkësisë ndërkombëtare duhet të jetë aq shumëdimensional si vetë sfidat, theksoi në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Për t’u marrë me simptomat, por edhe për të trajtuar shkaqet rrënjësore, ne kemi nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse. Një ushtri e fuqishme është një komponent kyç i një qasjeje të tillë gjithëpërfshirëse. NATO tashmë është përshtatur”. NATO ka rritur ndjeshëm dhe forcuar mbrojtjen kolektive, që “në fakt është rritja më e fortë e mbrojtjes sonë kolektive që nga

ka nxitjen e bashkëpunimit më të madh të mbrojtjes dhe industrinë e mbrojtjes mes kombeve evropiane dhe Bashkimi Evropian është forcimi i bazës së mbrojtjes të Evropës industriale”. Të gjitha këto janë shembuj se sa i rëndësishëm është BE kur është fjala për zhvillimin e bashkëpunimit të mbrojtjes në mes të shteteve evropiane. “Dhe sa e rëndësishme është gjithashtu që NATO dhe BE të punojnë ngushtë së bashku” vijoi Stoltenberg. Ai tha se “ndërsa Federika sapo ka nënvizuar që jemi të dy palët shumë të vendosur për të qenë në gjendje për të zhvilluar këtë bashkëpunim. Unë vlerësoj bashkëpunimin e ngushtë që kam pasur me Federikën dhe mënyrën se si ne së bashku jemi në gjendje për të ecur përpara në këtë axhendë të rëndësishme të bashkëpunimit. Veprimet tona tregojnë se si NATO dhe BE janë të vendosur për të sjellë stabilitet në rajonin tonë dhe janë duke punuar shumë për të arritur këtë”. Por, ai tha se ndërsa ndërmarjet janë kaq të larta, dhe nevojat janë në rritje, NATO dhe BE-ja



fundi i Luftës së Ftohtë. Me një Forcë të Reagimit të NATO-s që është dyfishuar në madhësi me 40.000 trupa. Në thelbin e saj është një forcë e re majë shtize që mund të vendoset brenda disa ditësh, në lindje apo në jug”. Stoltenberg tha se “Operacionet tona të mëdha ushtarake, në Afganistan dhe në Kosovë, kanë pasur të gjitha një aspekt të rëndësishëm, kundër terrorizmit. Në lindje, ne kemi rritur praninë tonë në ajër, në det dhe në tokë, për të siguruar aleatët tanë. Ne po krijojmë tetë selitë e reja të vogla të aleatëve tanë lindorë për të koordinuar trajnimet dhe stërvitjet. Për të mbështetur planifikimin e mbrojtjes kolektive, dhe nëse është e nevojshme, për të ndihmuar vendosjen e shpejtë të përforcimeve të NATO-s”.

Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian është duke luajtur një rol të rëndësishëm. Përmes sanksioneve ekonomike, BE-ja ka bërë të qartë se veprimet agresive të Rusisë kanë kostot dhe pasojat. Ajo është në krye të krizës së refugjatëve këtu në Evropë. Për të ndërtuar stabilitet dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik. Ajo

mund të bëjnë edhe më shumë së bashku, “besoj se ne mund të arrijmë shumë më tepër së bashku në partneritet”, për të mbajtur qytetarët tanë të mbrojtur dhe të sigurtë.

Duke folur për një potencial të konsiderueshëm në disa fusha për përmirësimin dhe rritjen e bashkëpunimit midis NATO-s dhe BE-së, ai përmendi tre prej tyre.

Së pari, kërcënimet hibride

“Sfidat e sotme ushtarake janë të kombinuara me mjete joushtarake. Lufta Hibride është reflektim i errët e vet “qasjes gjithëpërfshirëse”. Ndërsa ne kërkojmë për të stabilizuar vendet, ata që përdorin luftën hibride kërkojnë destabilizimin e tyre. Sigurisht, lufta hibride nuk është e re. Ajo është po aq e vjetër sa edhe kali trojan. Ajo që është e ndryshme është shkalla e saj, shpejtësia e saj dhe intensiteti i saj. Dhe kjo e vërtetë është në kufijtë tanë. Si NATO dhe BE-ja janë duke kërkuar për tu përgatitur, për të penguar dhe mbrojtur kundër luftës hibride. Që të dy organizatat kemi mjete civile dhe ushtarake që plotësojnë njëri-tjetrin. Duke i kombinuar



këto mjete mund të bëjmë një ndryshim të madh. Kjo është arsyeja pse është e domosdoshme që ne të punojnë ngushtë së bashku në disa fusha: Përmirësimin tonë të vetëdijes, të situatës, gadishmërisë civile dhe elasticitetin, mbrojtjen kibernetike, komunikimet strategjike, trajnime dhe stërvitje të përbashkëta. Kështu që kur një krizë lind, secili nga ne di të thërrasë në anën tjetër të qytetit.

Zona e dytë për bashkëpunim më të ngushtë NATO-BE, ndihmon part-

nerët në rajon

“NATO dhe BE punojnë shumë për të mbështetur partnerët tanë, në përballjen e tyre me kërcënimet nga Rusia, apo dhunën dhe kaosin nga grupet terroriste. Çdo aleat i NATO-s kontribuon në koalicionin global për t’iu kundërvënë dhe për të shkatërruar ISIS. Ne jemi gjithashtu mbështetje e vendeve të tilla si Jordania, Tunizia, Iraku, Ukraina, Moldavia dhe Gjeorgjia dhe shumë të tjerë. Pra, ata mund të mbrojnë veten më mirë dhe të ndihmojnë në ruajtjen e stabilitetit në rajonin e tyre, pa pasur nevojë për ne që gjithmonë të vendosim një numër të madh të forcave tona luftarake. NATO qëndron e gatshme për të ndërhyrë kur është e nevojshme. Por ne të gjithë e dimë se në afat të gjatë, parandalimi është gjithmonë më mirë sesa intervenimi. BE-ja është gjithashtu për rritjen e aftësisë mbrojtëse të partnerëve të saj, si dhe duke ndihmuar për të zhvilluar ekonomitë e tyre dhe institucionet e tyre politike. Pra veç e veç, ne jemi duke bërë një ndryshim.”

Fusha e tretë, për një bashkëpunim më të ngushtë të Industrisë së Mbrojtjes dhe Sigurisë në Evropë

“Ju jeni tashmë ndër industritë më të avancuara dhe më konkurruese në botë. Ashtu si Federika edhe unë jemi të vendosur në atë se kjo qëndron në këtë mënyrë. Autonomia evropiane është e rëndësishme, por kjo nuk duhet të përjashtojë një dimension të fortë transatlantik. Në një treg global, ju përballeni me sfidën e qëndrimit konkurrues. Dhe ne duhet të sigurohemi që aleatët mund të mbajnë epërsinë e tyre ushtarake. Ne kemi nevojë për të qëndruar kurbë në të ardhmen në risinë e mbrojtjes. Kjo është arsyeja pse ne kemi krijuar Forumin NATO-industri. Kjo është arsyeja pse unë i mirëpres investimet nga BE-ja në përdorim të dyfishtë të hulumtimit të aftësive. Aleatët e NATO-s mbështeten në një industri konkurruese mbrojtjes dhe të sigurisë. Por industria gjithashtu mbështetet në vendimet e marra nga vendet përmes NATO-s. NATO përcakton prioritetet e planifikimit të mbrojtjes, kështu që aleatët mund të përqëndrohen në aftësitë kritike, si të zbulimit dhe vëzhgimit, ose transportin ajror strategjik. NATO vendos standardet për sektorin e mbrojtjes, për të siguruar efikasitet, zgjidhje me kosto efektive dhe ndërvepruese. Dhe, më e rëndësishmja nga të gjitha, ne kemi vendosur udhëzimet për shpenzimet e mbrojtjes, me të 28-të kryetarët e shteteve dhe qeverive në kryerjen e shpenzimeve në 2% të GDP-së në fushën e mbrojtjes, ndërsa ekonomitë tona rriten. Ne nuk jemi ende atje. Fotografia është e përzier, por ka progres. Për shembull, Estonia dhe Polonia në këtë vit kanë arritur në 2 për qind dhe shumë aleatët e tjerë në Evropën Qendrore dhe Evropën Lindore kanë hedhur në plan për të bërë të njëjtën gjë. Mbretëria e Bashkuar ka rritur shpenzimet e mbrojtjes në terma realë dhe do të qëndrojë mbi 2 për qind. Franca është afër 2 për qind dhe Gjermania po bën përpjekje për të rritur shpenzimet e saj të mbrojtjes.”

E gjithë kjo çështje dhe e gjithë kjo panoramë tregon se gjithnjë e më shumë aleatët janë duke lëvizur drejt qëllimit 2 për qind. Tani është koha për të investuar në mbrojtjen tonë. Bashkëpunimi i ngushtë mes NATO-s dhe BE-së nuk është vetëm diçka që ne duhet të bëjmë. Kjo është ajo që ne kemi nevojë të bëjmë. Ne ndajmë më shumë se të njëjtat anëtarë dhe të njëjtin njerëz. Ne ndajmë të njëjtat vlera. Angazhimin për lirinë dhe demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Dhe këto vlera janë nën kërcënim. Kjo është ajo që kemi parë në Paris të premtën, më 13 nëntor. Këto vlera duhet të mbrohen nga ne. Kjo është arsyeja pse ne punojmë së bashku. Kjo është arsyeja pse ne tani duhet të ndërmarrim bashkëpunimin tonë në nivelin e ardhshëm. Jo vetëm krah për krah, por edhe dorë më dorë. Kjo është mënyra që ne të përmirësojmë bashkëpunimin midis NATO-s dhe Bashkimit Evropian”.

Terrorizmi nuk do të mposhtë demokracinë

MIMOZA GOLIKJA

Në mbrëmjen e 13 nëntorit 2015, një seri e koordinuar e sulmeve terroriste, të përbëra nga të shtëna masive, shpërthime vetëvrasëse dhe marrje peng, ndodhën në Paris, në kryeqytetin e Francës dhe rrethinat e saj veriore, Saint-Denis. Duke filluar në orën 21:20, sipas orës lokale pati tre shpërthime vetëvrasëse jashtë Stade de France, pushkatime masive dhe një tjetër sulm vetëvrasës në katër lokacione afër qendrës së Parisit. Sulmi më vdekjeprurës ishte në teatrin Bataclan, ku sulmuesit morën edhe pengje. Sulmet vranë 129 njerëz, 89 prej të cilëve ishin në teatër Bataclan, 352 persona u shtruan në spital me plagët e marra në sulmet, nga të cilët 80 persona të përshkruar me plagë të rënda. Përveç viktimave, vdiqën shtatë terroristë dhe autoritetet vazhduan kërkimin për çdo bashkëpunëtor të tyre ende të lirë. Këto ishin sulmet më vdekjeprurës në Francë që prej Luftës së Dytë Botërore dhe sulmet vdekjeprurës në Evropë që nga shpërthimet e trenave në Madrid në vitin 2004.

Shteti Islamik i Irakut dhe Levant (ISIS) mori përgjegjësinë për sulmet, dhe presidenti francez Francois Hollande deklaroi se ai e konsideronte sulmin si “një akt i luftës” kryer nga ISIS, “e planifikuar në Siri, e organizuar në Belgjikë, kryer në tokën tonë me pjesëmarrje franceze”. Franca ka bombarduar objektiva të ndryshme në Lindjen e Mesme, duke përfshirë Sirinë, që nga tetori 2015, ISIS deklaroi se kjo ishte hakmarrje për përfshirjen franceze në Luftën Civile të Sirisë dhe Luftën Civile Irakut. Më përpara se të ndodhnin sulmet në Paris ISIL kishte marrë përgjegjësinë për disa sulme, të tilla si shpërthimet binjake vetëvrasëse në Bejrut dy ditë më parë. Franca ka qenë në gatishmëri të lartë që nga sulmeve e janarit 2015 në Paris, ku mbetën të vrarë 17 persona, duke përfshirë civilë dhe oficerë të policisë.

Në përgjigje, të ngjarjes së fundit në Paris, Franca ka shpalluar gjendjen e jashtëzakonshme, e para që prej trazirave të vitit 2005, dhe janë vendosur kontrolle të përkohshme në kufijtë e vendit. Njerëz nga mbarë bota dhe organizata shprehën solidaritetin, me popullin francez.

Flamujt në selinë e NATO-s ulen në solidaritet me Francën

Flamujt e vendeve aleate të NATO-s janë valëvitur në gjysmë shtizë, në Shtabin e NATO-s të shtunën më 14 nëntor 2015, për të nderuar viktimat e sulmeve terroriste në Paris dhe në solidaritet me popullin e Francës, pas sulmeve të tmerrshme terroriste të së premtes më 13 nëntor në Paris. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dënoi ashpër sulmet,



duke thënë se “ne qëndrojmë të fortë dhe të bashkuar në luftën kundër terrorizmit”. Terrorizmi nuk do ta mposhtë demokracinë”. Në mesditë e ditës së hënën më 16 nëntor 2015, shtabi ndërkombëtar i NATO-s, Stafi Ushtarak Ndërkombëtar, dhe delegacionet kombëtare respektuan me një minutë heshtje në Shtabin e NATO-s në kujtim të viktimave të sulmeve terroriste në Paris dhe në solidaritet me Francën. Pas minutës të heshtjes, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s lexoi deklaratën nga Këshilli i Atlantikut të Veriut. Ceremonia ishte e hapur për mbulimin mediatic, ajo u zhvillua në hyrjen kryesore (Cour d'honneur), dhe u vu në dispozicion të medias nëpërmjet satelitit dhe në faqen e internetit të NATO-s, duke i dhënë qasje që nga ora 11.30.

Këshilli i Atlantikut të Veriut dënon sulmet terroriste në Paris

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dorëzoi deklaratën e Këshillit pas një minutë heshtje të mbajtur në mesditë në selinë e NATO-s. Ambasadorët aleatë, së bashku me stafin ndërkombëtar të NATO-s, Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar dhe delegacionet kombëtare u mblodhën për të nderuar viktimat dhe në solidaritet me Francën.

Këshilli i Atlantikut të Veriut, që përfaqëson të gjitha aleatët e NATO-s, dënoi ashpër sulmet terroriste të së premtes në datën 13 nëntor në Paris. Në një deklaratë të lëshuar të hënën më 16 nëntor 2015, Këshilli i quajti sulmet barbare “një sulm në vlerat tona themelore të lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut”. Këshilli shprehu ngushëllimet më të thella për familjet e viktimave, dhe “solidaritet të fortë me qeverinë dhe popullin e Francës në vendosmërinë e tyre të palëkundur për

t’iu kundërvënë kërcënimit terrorist”. Aleatët u shprehën se ata ishin më të vendosur se kurrë për të luftuar dhe mposhtur terrorizmin dhe ekstremizmin. Këshilli më tej vuri në dukje se “një numër i aleatëve janë duke punuar me Francën në operacionet e tyre të vazhdueshme dhe hetimet”. Këto sulme kanë për qëllim për të trembur, por ata vetëm do të forcojnë vendosmërinë tonë. Terrorizmi dhe ekstremizmi nuk mund të mposhtë demokracinë dhe shoqëritë tona të hapura”, deklaroi Këshilli.

“Ne kemi mbajtur një minutë heshtje në NATO në kujtim të viktimave të sulmeve barbare terroriste në Paris. Aleatët qëndrojnë së bashku me

Stoltenberg: Ne qëndrojmë të fortë dhe të bashkuar në luftën kundër terrorizmit

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dënon sulmet terroriste në Paris

Jam i tronditur thellë nga sulmet e tmerrshme terroriste anembanë Parisit sonte. Mendimet e mia janë me familjet e viktimave, me të gjithë ata që janë prekur dhe me popullin e Francës. Ne qëndrojmë të fortë dhe të bashkuar në luftën kundër terrorizmit. Terrorizmi nuk do ta mposhtë demokracinë.
13 nëntor 2015

Francën në dhimbje dhe solidaritet. Ne i dënojmë këto sulme në mënyrën më të fuqishme. Ato ishin sulme mbi vlerat tona themelore të lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Ne shprehim ngushëllimet tona më të thella për familjet e viktimave. Mendimet tona janë gjithashtu me ata që u plagosën. Ne qëndrojmë në solidaritet të fortë me qeverinë dhe popullin e Francës në vendosmërinë e tyre të palëkundur për t’ju kundërvënë kërcënimit terrorist. Ne jemi të gjithë më shumë se kurrë të vendosur për të kundërshtuar kërcënimin e terrorizmit dhe ekstremizmit. Një numër i aleatëve tashmë janë duke punuar me Francën në operacionet e tyre të vazhdueshme dhe hetimet në

vazhden e sulmeve.


Këto sulme kanë për qëllim për të trembur, por ata vetëm do të forcojnë vendosmërinë tonë. Terrorizmi dhe ekstremizmi nuk mund të mposhtin demokracinë dhe shoqëritë tona të hapura”. Para momentit të heshtjes, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg nënshkroi librin e zisë në Delegacionin francez në NATO, për viktimat e sulmeve. “Ngushëllimet e mia më të thella, ... terrorizmi nuk do të mposhtë demokracinë”, shkroi Stoltenberg. Në ceremoninë e nënshkrimit, Sekretari i Përgjithshëm u prit nga ambasadori Jean-Baptiste Mattei, Përfaqësuesi i Përhershëm i Francës në Këshillin e Atlantikut të Veriut.



Pushka e dëshmorit Jonuz Pashaj gjëmoi në çdo cep të Shqipërisë

Sipas kujtimve të veteranit Ahmet Aliko

Luftëtarin e paepur dhe dëshmorin Jonuz Pashaj, e njoha në Berat, në shtatorin e vitit 1943, kur Italia fashiste kishte kapitulluar. Unë me 100 partizanë nga qarku i Gjirokastrës erdhëm këtu për të shkuar në Br.2 S, që do formohej në malet e Orenjës në Çermenikë. Atje ne ndenjëm 3-4 ditë, ku pritëm partizanët e Mallakastrës dhe të qarkut Beratit. Në këtë kohë qyteti ishte çliruar nga italianët, por Gjin Marku kishte bërë kompromis me gjermanët, ndaj në qytet kishte dhe ballistë dhe gjermanë që hynin e dilnin ditën dhe nuk goditeshin nga partizanët e Beratit. Jonuzi erdhi bashkë me 30-40 partizanë nga Mallakstra. Unë u njoha me Jonuzin që ditën e parë mbasi na u caktua në shërbim për të patrulluar në qytetin e Beratit. Këtu mësova se Jonuzi kishte marrë pjesë në luftimet e Mallakastrës, Patos-Margëllic, Qafë Koshicë, Kapaj, Rubije, Symizë, Greshicë etj. Në saj të përvojës së krijuar si partizan, Jonuzi u caktua përgjegjës patrulle mbasi ishte më i madh nga ne dhe i dinte mirë rregullat ushtarake, ishte i pjekur në mendime dhe shumë gjakftohtë. Në ditën e dytë shkuam në pazarin e Beratit ku gjetëm një ballist që kishte nxjerrë dhe shiste 4-5 pushkë dhe disa fishekë në një arkë. Jonuzi e pyeti: - Pse i ke këto armë këtu? Ai u përgjigj se i shes 5 napolona njërën, po të doni merrni ndonjë. Unë u inatoso dhe e kapa ballistin për kopsës të xhakës. Jonuzi më ndaloi, i foli ballistit që të se kjo është detyra jonë, kështu i morëm armët dhe ballistin e çuam në komandën e qarkut. Jonuzi bisedoi me Neshat Hysin, i cili në atë kohë ishte në komandë dhe ne u larguam. Jonuzi më këshilloi duke më thënë se, po të godisja ballistin ishte akt politik dhe hapej vëllavrasje. Jonuzi ishte i zeshkët në fytyrë, me vetulla të trasha dhe me mustaqe të zeza të dendura, me fytyrë të qeshur dhe babaxhan, me trup të bëshëm dhe fjalët e tija të urta e të avashme e bënin më të lezetshëm. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, më 15 tetor 1943, forcat tona u dërguan në Dibër të Madhe, në ndihmë të forcave partizane që zhvillonin luftime të ashpra kundër forcave gjermane dhe tradhëtarëve. Miqësia e filluar me Jonuzin në Berat po forcohej gjatë rrugës e peripeçive që kaluam në Sulovë, Dumre, gjithë kohës derisa arritëm në bazën partizane të batalionit Çermenikë. Jonuzi rregulloi partizanët e skuadrës që komandonin, duke krijuar kushte jetese, me ato pak mundësi që afronte vendi atje. Nga kjo përkujdesje të Jonuzit përfituam dhe ne se, ai na mësoi si ta rregullonim vendin e fjetjes, se ishte shumë ftohtë. Shirat e vjeshtës dhe të ftohtit na hynë në palcë. Jonuzi na këshilloi që të ruheshim për të mos u plevitosur. Atje ne pritëm 20-25 ditë për grumbullimin e forcave të reja të brigadës. Bukën e kishim shumë të pakët, 200 gr. brumë në ditë. Jonuzi kishte eksperiencë dhe një ditë me një shokun tim, Alem Çakon, shkuan në kuzhinën e robërve të luftës italianë, që kishin mbetur të grumbulluar për një kohë, se më vonë u ndanë nëpër fshatra. Atje Jonuzi mori një këmbë mish kali bashkë me Alemin dhe e solli tek ne duke na thënë se, është mish lope dhe ne u gëzuam. Të urritur, e morëm mishin e poqëm me shufra pjesë-pjesë. Mbasi e hëngrëm, Abazi e merr vesh dhe vjen e na thotë se, mishi që hëngërt është mish kali. Ne na pëlqeu, ndërsa Abazi u nevrikos dhe i foli Jonuzit rëndë. Por Jonuzi i tha duke qeshur, se ishte mish shumë i mirë. Na vjen urdhëri që do shkojmë në Dibër të Madhe në ndihmë të partizanëve të Haxhi Lleshit. U nisëm në Dibër. Jonuzi bashkë me partizanët e skuadrës dhe gjithë batalionin luftuan tre ditë duke thyer sulmet e mercenarëve dhe të gjermanëve. Ditën e fundit mbeti i rrethuar në një shtëpi nga gjermanët me 10 parti-



zanë. Jonuzi me granata del nga rrethimi, tërhiqet pa humbje dhe ndjek pjesën tjetër të batalionit dhe rrugë pa rrugë arrin forcat në Kaptinë të Martaneshit, pa pasur asnjë humbje, duke i shkatëruar armikut dëme në njerëz me disa të vrarë dhe të plagosur. Një episod tjetër, më kujtohet se shtabi ynë na ngarkoi me detyrë 4 shokë, ku ishte dhe Jonuzi, për të shkuar në fshatin Lunik, tek një kazermë e italianëve, e cila ishte në rrugën automobilistike Librazhd-Dibër. Atje ndodhej një bateri artilerie me katë topa, me municione dhe pajime. Na dhanë 30 ushtarë italianë dhe 30 mushka me vete. Në vendin e baterisë ishin roje 3 partizanë, dy prej të cilëve ishin bërë ballista dhe ishin marrë vesh me ballistat e fshatit që kur të vinim ne, të mos na i linin armët për të marrë. Ne me Jonuzin shkuan atje dhe u thamë përgjegjës të rojeve se, nesër në mëngjes, bateria do ngarkohet. Ata na thanë se pa urdhërin e Komandantit të tyre, që dhe ai kishte tradhëtuar, nuk i ngarkojmë dhe nuk jua japim. Jonuzi me gjakftohtësi i tha përgjegjës të rojeve se ja ku e kemi urdhërin se bateria duhet të nxirret dhe të ngarkohet natën, n.q.s. kundërshtojnë rojet, t'i arrestojmë. Mirëpo ne ishim pak dhe ata

kishin çetën e ballit atje afër. Njëri nga partizanët, nga Martaneshi, emri i të cilit nuk më kujtohet, na ndihmoi. Ngarkuam armët për gjithë natën dhe u nisëm në mëngjes bashkë me partizanët roje të baterisë. Jonuzi dinte pak italisht dhe i organizoi ushtarët italianë në bateri të rregullt, u dha dhe municion, duke u thënë se po na ndaluan për të na marrë topat, do luftojmë së bashku. Befas në të dalë të fshatit na dolën 30 ballista dhe na bënë thirrje nga prita e tyre që të shkakohen armët dhe të lihen, se do hapim zjarr. Ne u bëmë gati për kundërpërgjigje dhe ushtarët italianë zunë pozicion. Jonuzi u ngrit në këmbë dhe u tha ballistave se armët janë tonat dhe ju hapni rrugë se, ndryshe do derdhet gjak kot, jemi vëllezër! Ne do të vazhdojmë rrugën, juve po deshët hapni zjarr! Në këtë kohë partizanët nuk ishin konfliktuar me armë me ballistët. Ne me këta topa mund të shkatërojmë fshatin, i tha Jonuzi. Ballistët nuk u bindën dhe bënin presion përsëri. Jonuzi në krye të kolonës dhe ne gati për zjarr kaluam priten me armët gati. Ballistët mbetën me gisht në gojë. Me këtë veprim të guximshëm Jonuzi tregoi zgjuarësi dhe trimëri. Kështu bashkë me shokët e çuam baterinë në gatishmëri të

rrethimin dhe kaloi Shkumbinin me 20 partizanë të tjerë duke iu bashkuar batalionit të parë të Br.I S, ku qëndroi dhe luftoi atje deri në bashkimin me Forcat e Br. 2 S. Jonuzi e kaloi operacionin armik të dimrit në luftime e përpjekje të shumta. Ai qëndroi si burrat me gjithë kushtet e vështira që iu krijuan në njësi ku bënte pjesë. Zoti bën mrekulli, kështu që në prill 1944, u takuam me Jonuzin prapë në Grabovë të Gramshit, kur ai me disa shokë u bashkua me brigadën e tij. Ne kur i pamë që na dolën përpara u çuditëm se si ishin gjallë, ne i dinim të vrarë gjatë rrethimit të brigadës në Çermenikë. Jonuzi ishte veshur me rroba gjermane dhe kishte po armë gjermane, që ia kishte marrë nazistëve gjatë luftimeve. Ai ishte bërë më serioz, më i pjekur dhe i matur. Na tregoi të gjitha peripeçitë që kishin hequr gjatë kohës së operacionit. Në këtë kohë Br. 2 S shkoi në Panarit për tu kompletuar me forca të reja. Atje qëndrova me Jonuzin disa ditë në pushim. Populli i Panaritit na priti mirë, ndiheshim si në shtëpitë tona. Jonuzi u fliste shokëve dhe fshatarëve për fitoren e sigurt të luftës sonë. Më pas Jonuzi me kompaninë ku bënte pjesë shkoi në afërsi të Leskovikut në roje të Kon-

gresit të Përmetit. Atje qëndroi derisa mbaruan punimet e Kongresit. Operacioni nazist i Qershorit e gjeti Jonuzin në fshatrat e Leskovikut ku mori pjesë në luftime në atë zonë dhe me ikjen e gjermanëve mbeti në prapavijat e armikut. Kompania e Jonuzit çliroi shumë fshatra dhe mjaft ish-ballista iu bashkuan radhëve të partizanëve. Jonuzi mori pjesë në të gjitha luftimet e Batalionit të Parë të Br.2 S. Bashkë me skuadrën e tij, në fshatin Kamenicë në muajin korrik 1944, rrethoi dhe asgjësoi 14 oficerë dhe ushtarë gjermanë me kompaninë e tij, ku ishte zv/komandant i saj. Ai hyri në shtëpinë ku ishin gjermanët, nxorri fëmijët dhe gratë jashtë dhe u hodhi bombat gjermanëve. Gjermanët nuk pranuan të dorëzohen, Jonuzi hipi në çatinë e shtëpisë dhe i vuri zjarrin shtëpisë. Gjermanët u detyruan të luftonin në shtëpi ku u dogjën 4 prej tyre, ndërsa të tjerët tentuan të dilnin, por Jonuzi me shokë i vrau në të dalë të kësaj shtëpie. Në këtë luftim u vranë 14 gjermanë, nga ne u vra 1 partizan dhe u plagosën 2 të tjerë. Jonuzi mori pjesë në luftimet e zhvilluara në Baban, Bozhigrad, Sul e gjetkë. Në muajin gusht 1944, Jonuzi me shokë u bëri pritë gjermanëve në afërsi të fshatit Helmës të Kolonjës. Mbas luftimit në pritë kjo kompani u drejtua për në fshatin Shtikë të Kolonjës, një fshat i lidhur me luftën dhe i lirë. Natën këtë fshat e kishin kapur një batalion me ballistë të Kolonjës. Në krye të kompanisë partizane ishte Kleanthi Manastirliu. Komandanti i skuadrës së parë dhe mitralieri i skuadrës bie në përpjekje në mëngjes me ballistët. Plagoset rëndë Kleanthi, vritet një partizan tjetër dhe fillon lufta. Jonuzi i jep urdhër kompanisë të rrethojë fshatin gjysmë harku dhe të godasë ballistët nga veriu i fshatit. Ballistët qenë futur në shtëpitë e fshatit dhe hapnin zjarr të dendur. Kompania me Jonuzin në krye kapi lartësinë në krye të fshatit dhe i theu ballistat që mbanin këtë lartësi. Ballistëve u erdhën forca të reja nga Butka dhe kompania u godit në krah, por Jonuzi nuk e lëshoi kodrën. Kur e pa që rrezikohej të rrethohej kompania, Jonuzi dha urdhër për tu tërhequr drejt pyllit të Kazilit. Ai ndenji në fund për të siguruar tërheqjen. Por, nga një shtëpi në distancë të afërt, ku ai nuk e priste u godit për vdekje nga një dorë tradhëtarë.

Kështu ra ky partizan trim nga Bejari i Mallakastrës, që luftoi heroikisht kundër nazistëve dhe tradhëtarëve të vendit nga Mallakstra në Berat, nga Çermenika në Dibër, nga rrethinat e kryeqytetit në Shqipërinë e Mesme dhe më vonë në qarkun e Korçës, Devollit, Kolonjës, Leskovikut etj. Pushka dhe automatiku i Jonuzit gjëmoi në çdo cep të Shqipërisë. Jonuzi për ne dhe brezat e ardhshëm do mbetet i gjallë. Për shumë vite shkolla 8-vjecare e Bejarit mbajti emrin e këtij hero të pavdekshëm. Nderim dhe respekt për jetën dhe veprën e dëshmorit Jonuz Pashaj!

Përgatiti: Shefqet Kërcelli

NË KUADËR TË 71- VJETORIT TË ÇLIRIMIT


Luftimet në krahinën e Dibrës në fundvitin 1943



Prof. Asoc. DR. BERNARD ZOTAJ

Pas kapitullimit të Italisë, forcat reaksionare të zonës së Dibrës bënë dy tentativa për të shpartalluar repartet partizane dhe këshillat nacionalçlirimtare në qark dhe për të shtënë në dorë qytetin e Peshkopisë, si dhe Dibrën e Madhe të çliuara nga UNÇSH. Por, pas dështimit të këtyre tentativave, reaksioni kërkonte një ndërhyrje më të gjerë të ushtrisë gjermane për të larguar forcat nacionalçlirimtare nga Dibra e Madhe e Peshkopia. Edhe pushtuesit hitlerianë e quanin Lëvizjen NÇI në Dibër një rrezik dhe kishin arritur në përfundim se nuk mund t'i largonin forcat partizane nga Peshkopia dhe Dibra e Madhe "pa forca të mëdha dhe pa armë të rënda". Njëkohësisht ata kishin vendosur që të armatosnin dhe të shfrytëzonin sa më shumë edhe forcat "nacionaliste", madje parashikonin që t'u ngarkonin sigurimin e zonës, kur të shikonin se LNÇI në Dibër do të ishte dobësuar aq shumë, sa të mos paraqiste më rrezik. Nga bisedimet e bëra midis tyre, njoftonte komanda e Armatës së 2-të të Blinduar, komandën e Korpusit XXI, është siguruar bashkëpunimi me komandantin e reaksionit Fiqiri Dine me 400 veta në kuadrin e aksionit "Edelveis".

Në luftimet në Dibër armiqtë dhe bashkëpunëtorët nuk e arritën qëllimin për të shuar LANÇI. Shtabi i Grupit të Dibrës nuk arriti dot të vinte në jetë udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm të datës 9 nëntor 1943, për organizimin e një operacioni kundër armikut dhe reaksionit, për shpartallimin dhe shkatërrimin politik të tyre. Arsye ishte se reaksionit në Dibër i erdhi në ndihmë pushtuesi gjermanë. Ndërsa Br. III S, të cilën Shtabi i Përgjithshëm e kishte urdhëruar të shkonte me shpejtësi në Dibër për të marrë pjesë në operacion, u vonua dhe u bllokua nga operacioni gjerman që po zhvillohej në Pezë. Nga goditja që kishin marrë në Dibër e Peshkopi për ditë me radhë nga forcat partizane, forcat pushtuese dhe reaksioni i qarkut të Dibrës filluan përgatitjet për një sulm më të fuqishëm për të rimarrë me çdo kusht këto qendra, që ishin në duart e partizanëve, si dhe për shkatërrimin e forcave partizane që vepronin në këto zonë. Më 16 nëntor 1943 armiku filloi luftimet kundër qytetit të Dibrës. Repartet naziste gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre ishin të shumta, duke kaluar mbi 5.000 ushtarë. Në mëngjes artileria e armikut hapë zjarr të dendur mbi qytet, shkatërroi shtëpitë, vrau gra, pleq e fëmijë. Rreth qytetit kishin zënë pozicione batalionet e Dibrës dhe Martaneshit, si dhe forca të tjera. Raporti i forcave ishte në favor të armikut. Me gjithë këtë, komanda partizane mori vendim që të luftohej për mbrojtjen e Dibrës. Hitlerianët ishin afër pjesëve të jashtme të qytetit kur partizanët hapën mbi ta zjarr të dendur. Detashmentet hitleriane dhe reaksionare u gozhduan në vend, megjithëse shoqëroheshin dhe me tanke e autoblanda.. Në këto kushte qëndresa e gjatë ishte e pamundur dhe rrezikonte asgjësimin e batalioneve partizane. Nga mesnata komanda partizane dha udhër që partizanët të tërhiqeshin dhe të kalonin në anën tjetër të Drinit, veprim ky që u bë në mënyrë të rregullt dhe të disiplinuar. Në luftime e sipër, një grup prej disa partizanë mbetën të rrethuar afër qytet. Pushtuesit dhe bashkëpunëtorët ju bënë thirrje partizanët të dorëzoheshin, por luftëtarët ju përgjigjën me zjarr. Nazistët gjermanë sulmuan për të kapur lartësinë ku po mbroheshin partizanët, por çdo përpjekje e tyre ishte e kotë. Ata e goditën grupin e luftëtarëve



me artileri e mortaja. Me iniciativën e tyre, luftëtarët trima sulmuan përpara me bomba dore, çanë rrethimin dhe u bashkuan me forcat e tjera të luftëtarëve. Por bashkëpunëtorët duke u ndihmuar nga forcat pushtuese morën iniciativën e veprimeve në qarkun e Dibrës, prandaj qëndrimi i formacioneve të mëdha partizane ishte i pamundur. Në zonë mbetën vetëm njësitë guerile partizane. Krerët e reaksionit në qarkun e Dibrës u lidhën me pushtuesit hitlerianë, duke u vënë në shërbim të tyre dhe duke zhvilluar luftime kundër forcave partizane.

Komanda gjermane e përfundoi hartimin e planit të operacionit të madh në Dibër me 10 nëntor 1943 dhe e pagëzoi me emrin "Edelveis" (emër i një lule mali). Qëllimi kryesor që kishte armiku në këtë operation ishte: spastrimi nga partizanët dhe pushtimi i zonës Dibër e Madhe-Peshkopi. U caktuan për zhvillimin e luftimeve 5 batalione këmbësorie (të Divizionit të 297-të, të Divizionit të 100-të dhe të Regjimentit II "Brandenburg", Detashmenti i 214-të i Sigurimit, 1 batalion tankesh (të Divizionit të 297-të), artileria e Divizionit të 297-të dhe të Divizionit të 100-të, nënreparte xheniere, gjithsej 6-7 mijë ushtarë). Drejtimi i operacionit iu ngarkua komandantit të Divizionit të 297-të. Në këtë plan veprimi përfshiheshin dhe forcat e reaksionit të Peshkopisë, të Dibrës, të Gostivarit, të Kërçovës dhe të Tetovës, më shumë se 1000 veta. Para se të nisnin veprimet luftarake, komanda pushtuese i pajisi bashkëpunëtorët shqiptarë me armatim dhe municionin e duhur dhe me 1000

uniforma. Në Dibër të Madhe dhe për qark kishte rreth 600 luftëtarë të UNÇSH (forca të Grupit të Dibrës), 1 batalion i Br. II S me luftëtarë të batalionit të Çermenikës dhe një numër vullnetarë të çetave territoriale të krahinës. Rreth 200 vullnetarë e partizanë të tjerë ndodheshin në Peshkopi dhe në Zërqa. Duke vlerësuar fitoret e arritura nga forcat partizane,



Shtabi i Përgjithshëm për mbrojtjen e Dibrës së Madhe dhe të Peshkopisë nga mësymja e forcave të reaksionit, e përgjigjti vëmendjen në mënyrë të organizimit të forcave luftëtare në qark. Ai theksonte se "keni grumbulluar të gjitha forcat në qendrat, si Dibër dhe Peshkopi, me qëllim që t'i mbronin nga fuqitë reaksionare, kështu që është transformuar karakteri i

luftës sonë nga ofensiva në defensivë". Ky veprim, analizonte Shtabi i Përgjithshëm, i ka bërë forcat tona "objektiva të vërtetë për armiqtë tanë dhe bashkëpunëtorët e tyre". Duke vepruar kështu, vazhdonte urdhri i Shtabit të Përgjithshëm, "... u është lënë dorë e lirë reaksionarëve që të vepronin në krahina, të bëjnë propagandën e tyre, kështu që të mobilizojnë forca për t'i hedhur në luftë kundër nesh, në këtë mënyrë ne kemi mbetur larg nga turmat e popullit". Shtabi i Përgjithshëm, mbështetur në këtë analizë realiste të gjendjes në urdhrin që i dërgonte komandës së Grupit të Dibrës, më 9 nëntor 1943, ndër të tjera jepte edhe idenë e veprimeve luftarake të ardhshme të forcave partizane të qarkut. Komanda e Grupit të Dibrës, e informuar për fillimin e mësymjes armike, vuri në gatishmëri forcat partizane e vullnetarë dhe mori masa për mbrojtjen e qytetit të Dibrës së Madhe duke vlerësuar se ky ishte edhe objektivi kryesor i sulmit të trupave gjermane dhe forcave reaksionare. Veprimet luftarake të forcave partizane në qytete do të kishin për objektivi jo ta mbanin atë me çdo kusht, por t'i shkaktonin armikut humbje sa më të shumta në njerëz dhe në mjete luftarake.

Mbrojtja e qytetit të Dibrës së Madhe u organizua rrethore, duke zënë pikat sunduese dhe në to u vendosën mitraloza, mortaja dhe topa. Për të penguar armikun gjatë afrimit u shkatërruan pjesë rrugësh që çonin në qytet dhe u hodh në erë ura e Spilesë mbi Drin. Armiqtë e filluan mësymjen e tyre më 16 nëntor 1943, rreth orës 10.30. Artileria armike godiste me breshëri zjarri të pandërprerë jo vetëm objektiva që mendohej se mund të ishin zënë nga forcat partizane, por edhe shtëpitë e qytetit të Dibrës së Madhe, shumë prej të cilave u shkatërruan dhe u dogjën plotësisht. Këmbësorët nazistë u penguan mjaft nga prishja e urës së Spilesë dhe nga shkatërrimet e tjera gjatë rrugëve, por megjithatë, ata mundën ta kalonin Drinin dhe pengesat e tjera, sido që dhe me humbje. Epërsia numerike, artileria e fuqishme dhe forcat e mjetet e shumta xheniere u dhanë atyre dorë t'i kapërcenin këto pengesa dhe t'i afroshin qytetit të Dibrës së Madhe duke e sulmuar nga lindja e nga jugu. Tanket, që vinin nga Struga, nuk e kaluan lumin Drin ditën e parë, për shkak të urës së prishur.

Në fillim komanda e forcave partizane

armiku të futej brenda në qytet, por të luftohej për ta rrethuar nga perëndimi e nga veriu, për të qëndruar të lira rrugët e tërheqjes. Luftimet vazhduan afër 10 orë pa pushim. Luftëtarët e UNÇSH thyen disa sulme të nazistëve gjermanë duke mos i lejuar që të pushtonin qytetin as ta rrethonin atë plotësisht. Forcat reaksionare ishin përqëndruar në veri dhe në verilindje të Dibrës së Madhe. Atyre u ishte caktuar si detyrë për të mbyllur rrugët e tërheqjes së partizanëve. Luftimet rreshtën deri afër orës 9 të mbrëmjes dhe qyteti vazhdonte gjithnjë të qëndronte në dorë të UNÇSH. Ushtria hitleriane kishte mundur të pushtonte vetëm disa shtëpi në anën jugore të tij. Popullsia nuk u largua, megjithëse u vranë e u plagosën shumë veta nga qitjet e artilerisë së nazistëve gjermane. Burra, gra, të rinj dhe fëmijë ndihmonin partizanët e vullnetarët me ushqime, shërbëni si korrierë, udhërrëfyes e zbulues, tërhiqnin dhe përkujdeseshin për të plagosurit. Ata që kishin armë luftuan krah për krah me partizanët. Ndërkaq, erdhi lajmi se gjermanët dhe tdrhtarët kishin pushtuar Peshkopinë. Vullnetarët dhe një pakicë partizanësh që ndodheshin në qytet qenë larguar pas një qëndrese të vogël dhe ishin tërhequr në rajonin malor të Slllovës në veri të Peshkopisë.

Komanda e forcave partizane të Dibrës e analizoi situatën e krijuar dhe arriti në përfundim se duhej lëshuar edhe Dibra e Madhe. Për shumë arsye luftimet aty nuk mund të vazhdonin më gjatë. Qyteti rrezikohej të shkatërrohej dhe popullsia të dëmtohej rëndë. Edhe forcat partizane e vullnetare rrezikoheshin të rrethoheshin nga çdo anë dhe të asgjësoheshin. Municioni që kishin luftëtarët e UNÇSH me vete ishte në të mbaruar. Xhenierët nazistë gjermanë po punonin me ngut për të ndrequr urën dhe armiku do të vinte në përdorim edhe tanket që kishin mbetur përkohësisht në bregun e majtë të Drinit për shkak të urës së prishur. Tërheqja u krye afër mesit të natës. Rruga e lëvizjes në drejtim të Sollokit ruhej nga çeta e Slllovës dhe nga fshatarë vullnetarë. Në këto luftime u vra dhe atdhetari trimi, 75 vjeçari Ismail Strazimiri. Partizanët e vullnetarët kapërcyen Drinin e Zi në fshatin Sollokiç, në perëndim të Dibrës së Madhe dhe dolën në rajonin e Shupenzës. Kalimi i lumit u bë me vështirësi të madha, sepse jo vetëm që lumi i Drinit ishte fryrë nga shirat, por edhe sepse vahet ishin zënë nga forcat e reaksionit. Prapë se prapë humbjet ishin të pakta, dy-tri veta të mbytur dhe dy të plagosur. Humbjet e forcave partizane edhe në luftimet katër të vranë e disa të plagosur, kurse armiqtë patën shumë më tepër dëme. Ndër partizanët dëshmorë ishte Hamdi Lleshi, komandant i çetës së Gollobordës, i cili u vra brenda në një autobлиндë të kapur nga UNÇSH, në kohën e kapitullimit të Italisë. Dëme të mëdha pati edhe popullsia e Dibrës së Madhe. Veç 20-30 të vranëve, shumica gra e fëmijë, më 17 nëntor 1943 në mëngjes qyteti u dogj dhe u plaçkit nga forcat reaksionare dhe nga ushtarët nazistë. Operacioni "Edelveis" vazhdoi deri më 7 dhjetor 1943. Nga dhjetori 1943, në qarkun e Dibrës vepronin vetëm njësitë të vogla luftëtarësh të UNÇSH në kushte jashtëzakonisht të vështira. Armiqtë në operacionin e tyre të madh në Dibër arritën një fitore të përkohshme. Por Lëvizja Nacionalçlirimtare në qark do ta rimerte veten dhe do të rritej, sidomos në pranverën e vitit 1944 ajo do të bëhej një faktor i rëndësishëm në luftën vendimtare drejt çlirimit të plotë të vendit, përkrah njëjësive të tjera partizane që erdhen nga jugu.

Nderim dhe homazhe në ditën e Çlirimit të Tiranës

Ministrja Kodheli vizitë në familjen e Dëshmorit të Atdheut Hamdi Mëzezi

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, me rastin e 71-vjetorit të çlirimit të Tiranës, bëri një vizitë në familjen e dëshmorit të atdheut Hamdi Mëzezi. Me këtë rast, ajo shprehu vlerësimet më të larta për aktin heroik të birit të kësaj familje, dëshmorin Hamdi Mëzezi, si dhe për qëndrimin patriotik që familja Mëzezi, një familjeje e njohur dhe e vjetër tiranase, ka mbajtur gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe më pas. Sot emrin e dëshmorit të atdheut Hamdi Mëzezi e mban djali i xhaxhait të tij. Në këtë vizitë ministrja Kodheli shoqërohej nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, si dhe nga drejtues të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes.



Homazhe pranë Monumentit të Partizanit

Paraditen e datës 17 nëntor 2015, zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, bënë homazhe dhe vendosën një kurorë me lule pranë Monumentit të Partizanit në sheshin me të njëjtin emër të kryeqytetit. Është një nderim që i bëhet luftës heroike të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i dëshmorëve të atdheut që flijuan jetën e tyre për çlirimin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë.